



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 04.03.2021

Nr: 08

VENDIM

PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR ORGANIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E
PROCESIT ZGJEDHOR NË ZONËN E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR,
NË NDIHMË TË KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR,
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO	Kryetare
Arens	ÇELA	Anëtar
Dritan	ÇAKA	Anëtar
Helga	VUKAJ	Anëtar
Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për miratimin e udhëzuesit/manualit për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor, në ndihmë të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021.

BAZA LIGJORE: Neni 20, paragrafët 1, shkronja "gj", dhe 3, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, dhe dëgjoi diskutimet e të pranishëmve, në zbatim të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafi 1, shkronja "gj", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,



Data: 04.03.2021
Nr. 08

Për miratimin e udhëzuesit "Për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor në ndihmë të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021."

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzuesin “Për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor, në ndihmë të anëtarëve të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ilirjana NANO

Kryetare

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

www.kqz.gov.al

UDHËZUES

**PËR ORGANIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN
E PROCESIT ZGJEDHOR NË ZONËN
E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR**

Në ndihmë të anëtarëve
të Komisionit të Zonës së
Administrimit Zgjedhor.

2021



Përmbajtja

Hyrje	4
RREGULLA TË ETIKËS.....	5
KREU I - SISTEMI I ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN.....	6
KREU II - INSTITUCIONET PËR PËRGATITJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE.....	8
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)	8
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri)	8
Komisioni Rregullator (Rregullatori)	8
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS).....	8
Administrata Zgjedhore	9
KREU III - ORGANIZIMI, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KZAZ-së.....	10
III.1 - Përbërja e KZAZ-së për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 :.....	10
III.2 - Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së.....	11
III.3 - Të drejtat dhe detyrat e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së.....	12
III.4 - Vakanca në KZAZ	12
III.5 - Ligji dhe parimet në të cilat mbështetet veprimtaria e KZAZ-së.....	13
III.6 - Detyrat dhe funksionimi i KZAZ-së	13
III.7 - Detyrat e kryetarit dhe sekretarit të KZAZ-së	16
III.8 - Selia dhe orari i punës së KZAZ-së.....	19
III.9 - Mbledhjet e KZAZ-së	20
III.10 - Marrja e vendimeve	21
III.11 - Konflikti i interesit	22
III.12 - Ankimi ndaj vendimeve të KZAZ-së	22
KREU IV - BASHKËPUNIMI, KOMUNIKIMI, NDËRVEPRIMI I KZAZ-së ME KQZ-në, KQV-në, POLICINË E SHTETIT, PARTITË POLITIKE, INSTITUCIONE DHE MEDIAN	23
IV.1 - Ndërveprimi KZAZ-së me KQZ-në.....	23
IV.2 – Ndërveprimi i KZAZ-së me KQV-në.....	24
IV.3 - Ndërveprimi i KZAZ-së me Policinë e Shtetit.....	25
IV.3 - Komunikimi i KZAZ-së me partitë politike	26
IV.4 - Bashkëpunimi i KZAZ-së me institucionet shtetërore	26
IV.5 - Komunikimi i KZAZ-së me Media	26
KREU V - LISTA E ZGJEDHËSVE.....	27
V.1 - Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve	27
V.2 - Pasaktësitë në listën e zgjedhësve	27
KREU VI - VËZHGESIT	28
KREU VII - DETYRAT E KZAZ-së PËR NGRITJEN E KQV-ve.....	30

VII.1 - Përbërja e KQV-së.....	30
VII.2 – Paraqitja e kandidaturave për anëtarë të KQV-ve:	31
VII.3 - Procedura për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KQV-së	32
VII.4 - Vakancat në KQV dhe plotësimi i tyre	32
VII.5 - Plotësimi kryesisht i vakancave në KQV	33
VII.6 - KQV-të E POSAÇME	34
VII.7 - Qendra e votimit.....	34
KREU VIII – ORGANIZIMI DHE PËRGATITJA E VNV-SË	35
VIII.1 - Përgatitja e VNV-së	35
VIII.2 - Organizimi i VNV-së, skema organizative e funksionimit të VNV	36
VIII.3 - Prezantimi i Vendit të Numërimit të Votave	37
KREU IX - DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KQZ NË KZAZ.....	38
IX.1 - Materiale zgjedhore që KZAZ merr në dorëzim nga KQZ	38
IX.2 - Materiale zgjedhore që KZAZ-ja i dorëzon çdo KQV-je	40
IX.3 - Materiale zgjedhore jashtë kutisë, të cilat i dorëzohen KQV-së nga KZAZ-ja:	41
IX.4 - Procedura për dorëzimin e vulës së kryetarit të KQV-së	41
KREU X - DITA E ZGJEDHJEVE	42
X.1 - Ndjekja dhe monitorimi i procesit zgjedhor	42
X.2 - Marrja në dorëzim e materialeve të votimit	43
KREU XI - SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE VEPRAT PENALE.....	45
XI.1 - Sanksionet administrative	45
VEPRAT PENALE.....	46
KREU XII - TESTI NJOHURIVE.....	49

Hyrje

Të nderuar anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor!

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju uron suksese në përmbushjen e detyrës së rëndësishme të anëtarit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve për Kuvendin, të datës 25 Prill 2021!

Anëtari i administratës zgjedhore gjatë ushtrimit të detyrës duhet të dëshmojë marrëdhënie besimi për zgjedhësit, në shërbim të interesit publik, për zgjedhje të lira dhe të ndershme, e ndërtuar mbi parimet:

- ✓ Parimi i ligjshmërisë dhe paanësisë, ku çdo shtetas që emërohet dhe merr pjesë në administrim zgjedhor, vepron në përputhje të plotë me Kodin Zgjedhor, aktet nënligjore të KQZ-së, dhe me rregullat për parandalimin e konfliktit të interesave.
- ✓ Parimi i unitetit dhe hierarkisë, administrata zgjedhore organizohet në mënyrë të atillë që çdo nivel i saj të mbikqyret, monitorohet dhe përgjigjet tek niveli më i lartë.
- ✓ Parimi i efektivitetit, administrata zgjedhore duhet të sigurojë efikasitetin në kryerjen e funksioneve dhe detyrave me profesionalizëm.
- ✓ Parimi i barazisë, administrata zgjedhore organizohet që t'u shërbejë me të njëjtën cilësi dhe transparencë të gjithë zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore.
- ✓ Parimi kolegjalitetit, çdo anëtar i administratës zgjedhore, bashkëpunon me anëtarët e tjerë të komisionit apo strukturës ku bën pjesë për arritjen e objektivave ligjore që u janë besuar, në përputhje me ligjin.

Njohja dhe përvetësimi i kuadrit ligjor zgjedhor, profesionalizmi dhe pavarësia në përmbushjen e detyrave, me paanësi, transparencë të plotë, dhe kolegjalitet, janë çelësi i suksesit për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në zonën e administrimit zgjedhor.

Detyra e anëtarit të administratës zgjedhore, ndonëse përmbillet në një periudhë të caktuar kohe, shënjon në opinionin dhe besimin publik tek procesi zgjedhor, duke siguruar të gjithë së bashku, zgjedhje me standarde ndërkombëtare!

RREGULLA TË ETIKËS

Anëtari apo sekretari i KZAZ-së, gjatë kryerjes së detyrës duhet të dëshmojë sjellje etike:

- Të zbatojë me përpikmëri Kodin Zgjedhor, aktet e KQZ-së, dhe vendimet e KZAZ-së;
- Të paraqitet rregullisht në detyrë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-së, me përjashtim të rasteve, kur për arsye objektive dhe me njoftim paraprak të Kryetarit të KZAZ-së, nuk mund të jenë të pranishëm;
- Të deklarojë menjëherë rastet e marrëdhënies së krushqisë të afërt ose gjinisë deri në shkallë të katërt, apo të marrëdhënies së punës me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë;
- Të veprojë në mënyrë të paanshme për zbatimin e detyrave, vendimeve të KQZ dhe KZAZ-së;
- Të mos lejojë që interesat private të bien ndesh me detyrën, të shmangë konfliktin e interesit dhe të mos shfrytëzojë detyrën për interesin privat;
- Të respektojë normat e njohura dhe të gjithëpranuara të etikës në komunikim e sjellje;
- Të jetë i ndershëm në kryerjen e detyrave, i përkushtuar dhe korrekt, duke patur parasysh vetëm interesin publik;
- T'i ofrojë çdo zgjedhësi cilësinë më të lartë të shërbimit të kërkuar, që zgjedhësit të ushtrojnë të drejtat e tyre në respektim të plotë të të drejtave dhe procedurave ligjore;
- Të trajtojë të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, kandidatët, partitë politike dhe votuesit, vëzhguesit, në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupi interesi;
- Të mos pranojë dhurata apo favore nga partitë politike, organizatat apo personat, të cilët mund ose jo të jenë të përfshirë në procesin zgjedhor;
- Të mos mbajë apo tregojë simbole, shenja dalluese, apo ngjyra partiake;
- Të mos shprehë pikëpamje mbi tema, të cilat mund të jenë çështje politike në zgjedhje;
- Të mos marrë pjesë në aktivitete të paautorizuara, përfshi edhe aktivitetet private, që mund të çojnë drejt një konflikti aktual apo të perceptuar interesi me detyrën e zyrtarit zgjedhor;
- Të deklarojë çdo marrëdhënie që mund të çojë në konflikt interesi me detyrat e tyre.
- Të jetë rigoroz në zbatimin e masave anticovid-19, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë;


Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, garanton opinionin publik, se do të ushtrojë të gjithë autoritetin ligjor, që zyrtarët zgjedhorë, të angazhuar për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, të kryejnë detyrat me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm, për të garantuar standarde të larta dhe integritetin e këtij procesi, si shërbim dhe detyrim ndaj zgjedhësve, subjekteve zgjedhore, vëzhguesve vendas dhe të huaj.

KREU I - SISTEMI I ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN

Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga **140 deputetë** të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumëemërore.

Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë zona zgjedhore:

- ✓ Përputhet me ndarjen administrative-territoriale të qarkut.
- ✓ Shërben si njësi zgjedhore për zgjedhjen e një numri të caktuar mandatësh:



- Zona zgjedhore qarku Berat 7 mandate
- Zona zgjedhore qarku Dibër 5 mandate
- Zona zgjedhore qarku Durrës 14 mandate
- Zona zgjedhore qarku Elbasan 14 mandate
- Zona zgjedhore qarku Fier 16 mandate
- Zona zgjedhore qarku Gjirokaštër 4 mandate
- Zona zgjedhore qarku Korçë 11 mandate
- Zona zgjedhore qarku Kukës 3 mandate
- Zona zgjedhore qarku Lezhë 7 mandate
- Zona zgjedhore qarku Shkodër 11 mandate
- Zona zgjedhore qarku Tiranë 36 mandate
- Zona zgjedhore qarku Vlorë 12 mandate

Subjekt zgjedhor:


- ✓ Është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët regjistrohen dhe depozitojnë në KQZ, listën shumëemërore të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore, sipas rregullave që përcaktohen në Kodin Zgjedhor;
- ✓ Shtetasi shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor.

Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ.

Zgjedhësi do të votojë vetëm në një fletë votimi, duke shënuar subjektin zgjedhor dhe/ose vetëm për një nga kandidatët e tij.

Në çdo qendër votimi do të vendoset vetëm një kuti votimi.

Zona e Administrimit Zgjedhor (ZAZ)



ZAZ ngrihen dhe funksionojnë për çdo lloj zgjedhjeje dhe referendumi. Juridiksioni territorial i ZAZ-së është i njëjtë me territorin administrativ të bashkisë, me përjashtim të bashkive që kanë më shumë se 80 mijë shtetas me të drejtë vote.

Për zgjedhjet parlamentare, të datës 25 Prill 2021, Komisioni Rregullator miratoi ngritjen e **92 ZAZ-ve**.

Bashkitë që kanë më shumë se një ZAZ janë: Shkodra, Lezha, Durrësi, Elbasani, Fieri, Lushnja, Korça, Berati, Kamzë, Tiranë, Vlorë.

Nxjerrja e rezultatit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë:


- ✓ KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhore në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.
- ✓ KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore. Subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi përjashtohen nga shpërndarja e mandateve.

KREU II - INSTITUCIONET PËR PËRGATITJEN DHE ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

- ✓ Është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore,
- ✓ Monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet,
- ✓ Zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor.

ORGANET DREJTUESE TË KQZ-së



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri)

- ✓ Është organ monokratik, që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së;
- ✓ Drejton dhe mbikëqyr, drejtpërdrejt ose nëpërmjet administratës së KQZ-së, veprimtarinë e administratës zgjedhore përgjatë zgjedhjeve dhe referendumeve;
- ✓ Drejton procesin e trajnimit dhe kualifikimit të administratës zgjedhore.

Nënkomisioneri bashkushtron me të drejta të barabarta me Komisionerin kompetencat për:

- ✓ Përzgjedhjen, monitorimin dhe zbatimin e teknologjisë për identifikimin elektronik të zgjedhësve.
- ✓ Përzgjedhjen, rekrutimin dhe trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë

Komisioni Rregullator (Rregullatori)

- ✓ Është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet;
- ✓ Funkcionon me kohë të pjesshme dhe e ushtron veprimtarinë në mbledhje publike, të cilat thirren nga Komisioneri.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS)

- ✓ Është organ kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor.
- ✓ Funkcionon me kohë të pjesshme dhe e ushtron veprimtarinë në seanca publike të shqyrtimit administrativ, të cilat thirren nga Komisioneri, me pjesëmarrjen e palëve të interesuar

Administrata Zgjedhore

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ)


Është organ kolegjal, përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen me vendim të Komisionerit.
Ngrihet dhe funksionon për zgjedhjet për Kuvendin, organet e qeverisjes vendore. Përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në zonën e administrimit zgjedhor (ZAZ).

Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV)

Është organ kolegjal, përbëhet nga 7 anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit.
Përgjigjet për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit.

Grupi i Numërimit të Votave (GNV)


Përbëhen nga 4 anëtarë, njëri prej tyre është numërues i parë dhe një tjerër sekretar;
Numërojnë votat në rang ZAZ-je;
Nxjerrin rezultatin e zgjedhjeve për çdo QV të zonës zgjedhore përkatëse për subjektet zgjedhore.



KREU III - ORGANIZIMI, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KZAZ-së

III.1 - Përbërja e KZAZ-së për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021:

Komisioneri me vendim nr. 40, datë 23.12.2020, caktoi partitë politike që do të propozonin anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve. Ndarja e vendeve në KZAZ:



PSD nuk paraqiti në afat kandidatura për 59 KZAZ. Në bazë të nenit 29 të Kodit Zgjedhor, vakancat në 59 KZAZ-të u plotësuan me kandidatura të paraqitura nga PS. Këto 59 KZAZ nuk kanë të njëjtën përbërje sikundër paraqitur në skemë.

Kryetarët dhe zëvendëskryetarët e KZAZ-ve janë emëruar nga Komisioneri sipas propozimeve të KZAZ-ve përkatëse:

Në **KZAZ-të me numër tek**, Kryetar është njëri nga anëtarët e propozuar nga Partia Demokratike.

Në **KZAZ-të me numër çift**, Kryetar është njëri nga anëtarët e propozuar nga Partia Socialiste.

Kryetari i KZAZ-së është i përkatësisë politike të kundërt me zv/kryetarin.

Sekretari i KZAZ-së është i përkatësisë politike të njëjtë me zv/kryetarin.

III.2 - Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së

Kushtet për shkarkimin nga detyra e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së

- Shkelin dispozitat e Kodit Zgjedhor ose të akteve nënligjore të KQZ-së lidhur me detyrat e KZAZ-së;
- Dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- Mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZAZ-së;
- Nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht në periudhën zgjedhore;
- Nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.

Kushtet për lirimin nga detyra të anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së

- Janë në marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;
- Janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumëemërore të subjekteve zgjedhore që konkurrojnë në zonë;
- Nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;
- Nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore;
- Subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre;

! Çdo anëtar apo sekretari i KZAZ-së, njofton Komisionerin, nëse një anëtar apo sekretari i KZAZ-së është të paktën në një nga kushtet e shkarkimit apo të lirimit nga detyra.

Njoffimi paraqitet i nënshkruar me argumente dhe fakte për shkeljen e pretenduar.

Kundër vendimit të Komisionerit për shkarkimin nga detyra të anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së, lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit.

** Anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së i shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionerit, nuk mund të emërohet më në përbërje të KZAZ-së, kur KAS-i në përfundim të shqyrtimit administrativ ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit.*

III.3 - Të drejtat dhe detyrat e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së

Anëtari i KZAZ-së <i>ka të drejtë :</i>	Sekretari i KZAZ-së <i>ka të drejtë :</i>
Të përfitojë shpërblim për punën e bërë, sipas masës së shpërblimit të përcaktuar në vendimin e Komisionerit.	
Punonjësi i administratës shtetërore ka të drejtë të angazhohet si komisioner zgjedhor, pasi të ketë njoftuar zyrtarisht eprorin direkt dhe njësinë e burimeve njerëzore për këtë veprimtari. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e detyrave funksionale, në përputhje me Ligjin "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike".	
Të mos humbasë të drejtat dhe detyrat në vendin e tij të punës, gjatë kohës që ushtron detyrën si anëtar apo sekretar i KZAZ-së.	
Të komunikojë dhe informojë, përmes administratës së KQZ-së, Komisionerin, për çdo problem që vlerëson të arsyeshëm.	
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të njihet me rendin e ditës dhe me materialet e mbledhjes së KZAZ-së, si rregull jo më vonë se 2 orë përpara zhvillimit të mbledhjes. ✓ Të japë mendimin e tij për çështje që shqyrtohen, me të drejtë vote 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të marrë pjesë në mbledhjet e KZAZ-së; ✓ Të diskutojë dhe të japë mendimin e tij për çështje që shqyrtohen, si anëtar pa të drejtë vote.
* Anëtari dhe sekretari KZAZ-së i emëruar kryesisht: <i>ka të drejta të njëjta me anëtarin dhe sekretarin e KZAZ-së të propozuar nga partitë politike.</i>	

III.4 - Vakanca në KZAZ

Vakanca në KZAZ krijohet nga:	Plotësimi i vakancës në KZAZ
Shkarkimi nga detyra i anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së	<ul style="list-style-type: none"> ✓ 15 ditëve nga data e krijimit të vakancës; ✓ 3 ditëve, gjatë periudhës së zgjedhjeve; ✓ jo më vonë se 3 orë nga çasti i krijimit të vakancës, në ditën e zgjedhjeve.
Lirimi nga detyra i anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së	
Dorëheqje e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së, i cili ka depozituar dorëheqjen në KZAZ	
Sekretari i KZAZ-së <ul style="list-style-type: none"> • bën shënime të përkatëse në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së; • njofton menjëherë KQZ-në dhe degën lokale të partisë përkatëse. 	
* Njoftim i bashkëngjitet një kopje e deklaratës së dorëheqjes.	
Anëtari apo sekretari i KZAZ-së i shkarkuar, liruar apo dorëhequr nga detyra, nuk mund të largohet nga KZAZ-ja, pa dorëzuar detyrën te zëvendësuesi.	

III.5 - Ligji dhe parimet në të cilat mbështetet veprimtaria e KZAZ-së

Veprimtaria e KZAZ-së:

a. Mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", dhe aktet nënligjore të miratuara nga KQZ-ja.

b. Bazohet në parimet e ligjshmërisë, kolegjalitetit, profesionalizmit, pavarësisë, paanësisë dhe transparencës.

III.6 - Detyrat dhe funksionimi i KZAZ-së

Veprimtaria e KZAZ-së drejtohet dhe mbikëqyret nga Komisioneri, drejtpërdrejt ose nëpërmjet administratës së KQZ-së.

DETYRAT E KZAZ-së	AFATI
Përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja;	25 Janar 2021 deri në dorëzimin e materialeve zgjedhore në KQZ
Propozon, me vendim, kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-së;	Në mbledhjen e parë
Harton planin e veprimeve;	Deri më 7 Shkurt 2021
Mban të informuar KQZ-në për kushtet e ndërtesave dhe ambienteve ku janë caktuar QV-të; Mbikëqyr dhe bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore për: • Përgatitjen dhe përshtatjen e mjediseve të QV-ve, • Përshtatjen dhe aksesueshmërinë e QV-ve për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.	Deri më 16 Mars 2021
Informon KQZ-në për qendrat e votimit ku janë regjistruar zgjedhës të pakicave kombëtare, numrin total të tyre dhe sipas përkatësisë;	30 Mars 2021
Bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore, për vënien në dispozicion të ambienteve dhe bazës së nevojshme logjistike, për funksionimin e KZAZ-së, KQV-ve dhe VNV-së;	
Organizon Vendin e Numërimit të Votave për: • Krijimin e kushteve për zhvillimin e procesit të numërimit; • Krijimin të një vendi /hapësire të përshtatshme që të jetë e shikueshme nga të gjithë vëzhguesit e akredituar, ku do të afishohen kopje të vulosura nga Sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së: - Tabelës së Rezultatit të QV-ve, - Tabelës përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së; - Vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve të ZAZ-së.	Menjëherë pas caktimit të Vendit të Numërimit të Votave

<p>Afishon në një vend të dukshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve • listën përfundimtare të zgjedhësve 	<p>Pas konstituimit 21 Mars 2021</p>
<p>Me kërkesë të zgjedhësve, lëshon vërtetim nëse emri i zgjedhësit ndodhet/nuk ndodhet në listën përfundimtare të zgjedhësve;</p>	<p>Deri më 23 Prill 2021</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Pranon propozimet e partive politike për anëtarët e KQV-ve; • Verifikon dokumentacionin e paraqitur; • Emëron anëtarët, kryetarët dhe sekretarët e KQV-ve; • Dërgon kopje të vendimeve në KQZ. 	<p>Jo më vonë se 26 Mars 2021 Jo më vonë se 31 Mars 2021 Jo më vonë se 31 Mars 2021 <i>Në çdo rast, jo më vonë se 5 Prill 2021</i></p>
<p>Cakton grupet e numërimit të votave të ZAZ-së;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pranon propozimet e partive politike për anëtarët e GNV-ve; • Emëron anëtarët e GNV-ve; • Kopje të vendimeve i dërgon në KQZ. 	<p>Jo më vonë se 10 Prill 2021 Jo më vonë se 13 Prill 2021 Jo më vonë se 15 Prill 2021 Menjëherë</p>
<p>Regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe, sipas rastit, verifikon informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në ZAZ-në përkatëse;</p>	<p>Menjëherë</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Pranon kërkesat e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve; • Akrediton vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të regjistruara në KQZ ose refuzon kërkesat për akreditim. 	<p>Jo më vonë se: data 10 Prill 2021; 5 ditë nga paraqitja e kërkesave</p>
<p>Përgjigjet për shpërndarjen dhe monitoron afishimin në çdo QV të materialeve informuese edukuese, të dërguara nga KQZ, në gjuhën shqipe dhe sipas rastit në gjuhë të pakicave kombëtare;</p>	<p>Pasi dërgohen nga KQZ</p>
<p>Administron buxhetin e caktuar me vendim nga Komisioneri;</p>	<p>Gjatë kohës së funksionimit</p>
<p>Merr masa për mbarëvajtjen e programeve të trajnimit të organizuara nga KQZ, duke njoftuar për datën, vendin, dhe orën e sesionit të trajnimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - partive politike që kanë propozuar anëtarë të KQV-ve dhe GNV-ve; - anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve; <p>Monitoron, mbikqyr dhe informon KQZ-në për pjesëmarrjen dhe ecurinë e sesioneve të trajnimit.</p>	<p>Sipas kalendarit të trajnimit të KQZ-së, Çdo ditë trajnimi</p>
<p>Merr në dorëzim materialet zgjedhore të dërguara nga KQZ-ja, sipas nenit 99 të Kodit Zgjedhor dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor;</p>	<p>Sapo ato mbërrijnë në KZAZ</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Mbikqyr, verifikon dhe informon për masat e sigurimit dhe ruajtjen e materialeve zgjedhore në KZAZ dhe KQV; 	<p>Sapo ato mbërrijnë në KZAZ, KQV</p>
<p>Garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit, sipas grafikut të hartuar me orare të përcaktuara për çdo QV;</p>	<p>Jo më vonë se ora 15:00 datë 24 Prill 2021</p>

Komunikon dhe bashkërendon masat me Policinë e Shtetit për rendin publik në funksion të zgjedhjeve për: - ruajtjen dhe sigurimin e ndërtesave, ku kryhet administrimi zgjedhor; - mjediset e QV-ve dhe jashtë qendrës së votimit; - shoqërimin e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit.	Para fillimit të ushtrimit të detyrave të Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve
Njofton Drejtorin e Policisë Vendore, dhe njofton menjëherë KQZ-në, për probleme që mund të lindin dhe kanë të bëjnë me sjelljen dhe qëndrimin e punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë ushtrimit të detyrave në shërbim të zgjedhjeve;	Sapo të konstatohen
Merr në dorëzim nga KQV-të materialet e votimit dhe kutitë e votimit me fletët e votimit;	Sapo ato mbërrijnë në KZAZ
Shqyrton dhe merr vendim për çështjen e dërguar nga të paktën dy anëtarë të KQV-së, apo të ankimuar në KZAZ nga subjekti i interesuar, kur KQV nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës;	Menjëherë
Njofton KQZ-në për: • Hapjen e QV-ve; • Fillimin e procesit të votimit për të gjitha QV-të.	Dita e zgjedhjeve 25 Prill 2021, Ora 6 ⁰⁰ Ora 7 ⁰⁰
Informon për pjesëmarrjen në votim të zgjedhësve të QV-ve nën juridiksion;	Ora 7 ⁰⁰ , 10 ⁰⁰ , 13 ⁰⁰ , 19 ⁰⁰
Informon për ecurinë e procesit të votimit, dhe menjëherë për çdo problem, si psh. pezullimi i votimit, vakanca në komisione, e tjera;	Në çdo kohë
Njofton KQZ-në për: • Mbylljen e procesit të votimit; - Numrin e QV-ve, të cilat mbyllin votimin në orën 19:00; - Numrin e QV-ve, që nuk kanë përfunduar ende procesin, për shkak të zgjedhësve që presin në radhë për të votuar në këtë orar. • Numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar për çdo QV dhe përkatësinë gjinore të tyre.	25 Prill 2021, ora 19 ⁰⁰
Njofton KQZ-në për: • Përfundimin e procesit të dorëzimit të materialeve të votimit në KZAZ, VNV; • QV-të, në të cilat nuk është zhvilluar procesi zgjedhor, nëse ka të tilla; • Kutitë e votimit me fletët e votimit apo kutitë e materialeve të votimit të vlerësuar "Kuti e Parregullt"	Jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit në QV
Kryen detyra të tjera që burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe aktet e KQZ-së.	

III.7 - Detyrat e kryetarit dhe sekretarit të KZAZ-së

DETYRAT E KRYETARIT TË KZAZ-SË
Drejton hartimin e planit të veprimeve të KZAZ-së, ku parashikon veprimtaritë, afatet kohore të realizimit të tyre, ndarjen e detyrave mes anëtarëve;
<ul style="list-style-type: none">• Thërret mbledhjet e KZAZ-së;• Udhëzon sekretarin e KZAZ-së për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e saj;• Drejton mbledhjen e KZAZ-së dhe në mungesë të tij, mbledhja drejtohet nga Zv.kryetari KZAZ-së;• Paraqet çështjen që është për shqyrtim dhe u jep fjalën anëtarëve për të diskutuar;• Mbyll diskutimet e mbledhjes;• Pas mbylljes së diskutimeve:<ul style="list-style-type: none">- paraqet me radhë propozimet dhe- fton anëtarët për votim për secilin propozim.
Dërgon në KQZ, për shqyrtim nga Komisioneri, brenda 24 orëve, çështje për të cilat KZAZ-ja nuk ka arritur të marrë vendim brenda afatit përkatës (KZ, n.35/5, V.nr.5/2020, n.23/7);
Përfaqëson KZAZ-në në marrëdhënie me institucionet e treta;
Administron buxhetin e KZAZ-së, të caktuar nga Komisioneri, në bashkëpunim me zv.kryetarin;
Drejton punën e KZAZ-së për përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme logjistike të VNV-së;
Nënshkruan, së bashku me zv.kryetarin, autorizimin e vëzhguesve, të miratuar me vendim nga KZAZ-ja;
Merr në dorëzim materialet zgjedhore të dërguara nga KQZ, së bashku me zv.kryetarin dhe sekretarin e KZAZ-së (KZ, n.99);
Harton, bashkë me Zv.Kryetarin, grafikun për shpërndarjen e bazës materiale zgjedhore nga KZAZ -ja në KQV (KZ, n.100);
Drejton punën e KZAZ-së, së bashku me zv.kryetarin, për monitorimin e ecurisë së procesit gjatë ditës së zgjedhjeve (KZ, n.115/1);
Përcjell menjëhere kërkesën organeve të Policisë së Shtetit, në rast të incidenteve të njoftuara nga KQV-ja;
Drejton, së bashku me zv.kryetarin, procesin e marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të materialeve të votimit nga KQV-ja në KZAZ, së bashku me zv.kryetarin dhe caktojnë: <ul style="list-style-type: none">✓ anëtarë të grupeve të marrjes në dorëzim, me përkatësi të ndryshme politike;✓ persona në ndihmë të grupeve të marrjes në dorëzim, të cilët merren kryesisht me sistemimin e kutive; Ata zgjidhen nga lista e anëtarëve të GNV-ve, duke garantuar në çdo rast baraspeshën politike shumicë-opozitë.

DETYRAT E SEKRETARIT TË KZAZ- së

Përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KZAZ-së;	Gjatë kohës/periudhës që ushtron detyrën
Mban, përgjigjet për administrimin e dokumentacionit të punës së KZAZ-së dhe i dorëzon ato në KQZ, në përfundim të procesit zgjedhor, bashkë me materialet e tjera të votimit;	Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së (LPM), Regjistrin e Korrespondencës, Regjistrin e Vendimeve, Procesverbalin e Konstatimit.
<ul style="list-style-type: none"> • Protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KZAZ-së • Regjistron aktet apo çdo dokumentacion tjetër, që dalin prej saj, duke plotësuar të dhënat sipas rubrikave përkatëse; 	Në Regjistrin e Korrespondencës
Mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;	Në dosje të veçanta
<ul style="list-style-type: none"> • Përgatit materialet për mbledhjen e KZAZ-së, sipas udhëzimeve të Kryetarit, dhe ua shpërndan ato anëtarëve; • Mban procesverbalet e mbledhjeve të KZAZ-së, ku pasqyron: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Veprimtarinë e KZAZ-së; ✓ Rezultatet e votimit për çdo propozim. • Kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KZAZ: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Në disa kopje/ekzemplarë, numri i të cilave i barabartë me numrin e subjekteve të interesuara; ✓ I vulos ato, brenda 24 orëve nga marrja e vendimit. 	Administron dhe arkivon ato në dosje të veçantë Në LPM Sipas modelit të miratuar dhe administron origjinalin në arkivin e KZAZ-së, në dosjen përkatëse;
<ul style="list-style-type: none"> • Regjistron vendimet e KZAZ-së; • U jep subjekteve zgjedhore, vëzhguesve ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës kopje të vërtetuara të: <ul style="list-style-type: none"> ✓ vendimeve të KZAZ-së; ose ✓ procesverbaleve të mbledhjeve të KZAZ-së; 	Në Regjistrin e Vendimeve dhe LPM Regjistron në Regjistrin e Korrespondencës, (KZ, n.34/e/ë, V nr.5/2020, n. 14/2/"e"/"ë", n.24/5)
<ul style="list-style-type: none"> • Regjistron marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të dërguara nga KQZ-ja, sipas nenit 99 të KZ; • Kujdeset për administrimin teknik dhe kushtet e ruajtjes së tyre, në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor; 	Në LPM (KZ, n.34/f, V nr.5/2020, n. 14/2/"f")
Lëshon vërtetime, me kërkesë të zgjedhësve, nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listën përfundimtare të zgjedhësve të ZAZ-së përkatëse;	- Plotëson model KZAZ 16 ose KZAZ 15; - Bën shënimet përkatëse në LPM dhe Regjistrin e Korrespondencës

<ul style="list-style-type: none"> • Regjistron vëzhguesit, e miratuar me vendim nga KZAZ-ja; • Vulos autorizimin me vulën KZAZ-së, pasi ka firmosur kryetari dhe zv.kryetari; • I pajis ata me autorizimin përkatës. 	Në LPM
Regjistron vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin KZAZ-së; (KZ, n.34/gj, V nr.5/2020, n. 14/2/ "gj")	Në LPM dhe Regjistrin e Korrespondencës
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkërendon me Policinë e Shtetit masat për rendin publik në funksion të zgjedhjeve; • I përcjell Policisë së Shtetit grafikun e miratuar nga KZAZ-ja për: <ul style="list-style-type: none"> - Dorëzimin e materialeve zgjedhore të KQV-të; - Emrat e kryetarëve dhe sekretarëve të KQV-ve dhe - Numrat e tyre të kontaktit. 	Dokumenton detaje në LPM I mban ato në dosje të veçantë (KZ, n.34/"h", V nr.5/2020, n. 14/2/"h")
<ul style="list-style-type: none"> • Administrojnë dokumentacionin zyrtar për ndërhyrjet e Policisë së Shtetit në rivendosjen e rendit publik, kur <ul style="list-style-type: none"> - Jashtë qendrës së votimit rrezikohet rendi ose - Pengohet procesi i rregullt i votimit. (KZ, n.34/"h", V nr.5/2020, n. 14/2/ "i") • Dokumenton çdo ndërhyrje të Policisë së Shtetit, sipas rasteve të parashikuara në n.109 të KZ (V nr.5/2020, n. 14/2/"j") • Njofton KQZ-në për të gjitha rastet e ndërhyrjes së Policisë së Shtetit. 	Në dosje të veçantë administrohet dokumentacioni për ndërhyrjet brenda ose jashtë mjedisit dhe/ose ndërtesave ku kryhet administrim zgjedhor. Bën shënimet përkatëse në LPM, njoftimin për incidentin dhe orën e marrjes së tij.
<ul style="list-style-type: none"> • Është përgjegjës për administrimin dhe përdorimin e vulës së KZAZ-së; • Njoftimin e menjëhershëm të KQZ-së dhe/ose Komisarariatit të Policisë së Shtetit për rastet e dëmtimit apo humbjes së vulës së KZAZ-së. 	Sipas rregullave: VKM nr. 390/1993 Akteve të KQZ-së, V nr.5/2020, n. 14/2/ "k" Pasqyron faktin dhe rrethanat në LPM dhe /ose Regjistrin e Korrespondencës
Firmos në fund të çdo faqeje të Procesverbalit të Mbledhjes dhe e vulos atë, pasi të kenë firmosur anëtarët e pranishëm në mbledhje;	Në LPM
<p>Është përgjegjës për administrimin e akteve dhe shkresave të KQZ-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> • I regjistron ato; • Njeh anëtarët e KZAZ-së me aktet përkatëse; Jep asistencë juridike për KZAZ-në për aktet e dërguara nga KQZ. 	Në dosje të veçantë, sipas objektit, Në Regjistrin e Korrespondencës Sapo ato mbërrijnë
Shënon kohën e ndërprerjes dhe rifillimit të punës së KZAZ-së	Gjatë procesit të numërimit të votave
<ul style="list-style-type: none"> • Regjistron/shënon të gjitha pasaktësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë: 	Në LPM dhe Procesverbalin e Konstatimit

<ul style="list-style-type: none"> ✓ Procesi të marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe materialeve të votimit nga KQV-ja në KZAZ (KZ, n.115/6, V nr.5/2020, n. 14/2/"II) dhe ✓ Procesi të numërimit të votave në VNV. • U jep Kopje të Procesverbalit anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare, <i>hëse e kërkojnë</i>; • Administrojnë origjinalin e Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim të KQV dhe KQV. • U jep nga një kopje të Procesverbalit Model KZAZ-24 "Për dorëzimin nga KQV në KZAZ të materialeve të votimit": <ul style="list-style-type: none"> ✓ anëtarëve të grupit të marrjes në dorëzim, ✓ kryetarit, sekretarit të KQV-së dhe ○ punonjësit të Policisë së Shtetit të caktuar për shoqërimin e materialeve të votimit. 	<p>Procesverbalin e Konstatimit</p> <p>Model KZAZ-24 "Për dorëzimin nga KQV në KZAZ të materialeve të votimit", në dosje të veçantë, së bashku me Modelet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Model KZAZ 22 "Për pajisjen nga KZAZ me materiale zgjedhore të KQV"; • Model KZAZ 23 "Për pajisjen e KQV nga KZAZ me vula me kode të sigurisë"; • Procesverbalin e përgatitur nga KZAZ për Listën e zgjedhësve, të cilën KQV e përdor në ditën e zgjedhjeve dhe Letrën e bardhë me modelin krahasues të vulës së Kryetarit të KQV-së.
<p>Është përgjegjës për transmetimin e informacionit në KQZ për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapjen e QV-ve; • Pjesëmarrjen në zgjedhje gjatë ditës së votimit; • Mbylljen e votimit. 	<p>Bën shënimet përkatëse në LPM</p>
<p>Njofton KQZ për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fillimin e procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore nga KQV-të në VNV; - Përfundimin e procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore në KZAZ, VNV; - QV-të, në të cilat nuk është zhvilluar procesi zgjedhor (nëse ka të tilla); - Kutitë e votimit me fletët e votimit apo kutitë e materialeve të votimit të vlerësuara "Kuti e Parregullt". 	<p>Jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit në QV</p> <p>Menjëherë sapo janë marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjithë QV nën juridiksion</p>
<p><i>Kryetari dhe Sekretari i KZAZ-së kryejnë detyra të tjera që buronin nga Kodi Zgjedhor dhe aktet e KQZ-së</i></p>	

III.8 - Selia dhe orari i punës së KZAZ-së

Në selinë e KZAZ-së, në vend të dukshëm vendoset flamuri kombëtar. Në hyrje të ndërtesës ku është vendosur selia e KZAZ-së, vendoset tabela treguese, e cila përmban numrin e KZAZ-së, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike të KZAZ-së.

Dokumenti i identifikimit

Gjatë ushtrimit të detyrës anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së, janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit të funksionit përkatës.

Vëzhguesit e akredituar në KZAZ, gjatë qëndrimit në mjediset e punës së KZAZ-së, janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin identifikues të lëshuar sipas rastit nga KQZ ose KZAZ, dhe të kenë kartën e identitetit (letër njoffimin).

Orari punës së K Z A Z - s ë

25 Janar 2021-21 Prill 2021	22 Prill 2021- 26 Prill 2021
09.00 – 13.00 dhe 16.00 - 20.00	Në mënyrë të përhershme në detyrë.

Kujdes! Ndërprerja dhe rifillimi i punës, në çdo rast, bëhet me vendim të KZAZ-së.

III.9 - Mbledhjet e KZAZ-së

Mbledhjet e KZAZ-së thirren nga Kryetari:

- Janë publike dhe zhvillohen vetëm në ambientet e punës së saj;
- Janë të vlefshme kur në to marrin pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të KZAZ-së.

Përgatitja e mbledhjes së KZAZ-së		
Kryetari i KZAZ-së	Sekretari i KZAZ-së	Anëtari i KZAZ-së
<ul style="list-style-type: none"> • Thërret mbledhjen e KZAZ; • Udhëzon Sekretarin të përgatisë materialet e mbledhjes së KZAZ 	<ul style="list-style-type: none"> • Afishon në hyrje të KZAZ-së njofftimin për thirrjen e mbledhjes së KZAZ-së, të paktën 24 orë përpara. <p><i>Njofftimi përmban: datën, orën, çështjet që do të diskutohen.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgatit materialet e mbledhjes. 	<p>Njihet me rendin e ditës dhe materialet e mbledhjes;</p> <p>Njoffton Kryetarin e KZAZ-së, kur për arsye objektive, nuk e ka të mundur të marrë pjesë.</p>

Zhvillimi i mbledhjes së KZAZ-së		
Kryetari i KZAZ-së	Anëtari i KZAZ-së	Sekretari i KZAZ-së
<ul style="list-style-type: none"> • Drejton mbledhjen e KZAZ-së; • Paraqet çështjen që është për shqyrtim; • U jep fjalën anëtarëve për të diskutuar. <p><i>Në mungesë të kryetarit mbledhja drejtohet nga zv.kryetari</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton, sipas rendit të ditës; • Paraqet propozime për çështje që janë në rendin e ditës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mban procesverbal në LPM të KZAZ-së, ku shënon: - datën, vendin dhe orën e mbledhjes; - anëtarët që morën pjesë; - çështjet që u diskutuan; - përmbajtjen e diskutimeve.
Mbyllja e diskutimeve		
<ul style="list-style-type: none"> • Mbyll diskutimet me pëlqimin e anëtarëve të KZAZ-së. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ka të drejtë të propozojë mbylljen e diskutimeve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shënon në LPM mbylljen e diskutimeve.

Votimi i propozimeve është i hapur. Votimi bëhet me ngritjen e dorës ose me deklaram.		
Paraqet me radhë propozimet; Fton anëtarët e KZAZ-së për të votuar për secilin propozim.	Anëtari i KZAZ-së voton "pro" ose "kundër". ! Abstenimi nuk lejohet. ! Nëse kërkon, anëtari i KZAZ-së ka të drejtë të shpjegojë votën.	! Nuk ka të drejtë vote; • Shënon në LPM rezultatet e votimit për çdo propozim; • Firmos dhe vulos me vulën e KZAZ-së procesverbalin në çdo faqe të LPM-së, pasi kanë firmosur të gjithë anëtarët e KZAZ-së, që kanë marrë pjesë në mbledhje.
Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të KZAZ-së, Kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një orë tjetër, të paktën dy orë pas të parës. ! Gjatë mbledhjes së KZAZ-së, ndalohet: a. Ndërprerja e fjalës së anëtarit që diskuton dhe komentet; b. Çdo lloj komunikimi me telefon ose forma të tjera komunikimi me të tretët.		

III.10 - Marrja e vendimeve

Vendimet e KZAZ-së:	Sekretari i KZAZ-së:
<ul style="list-style-type: none"> • Merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së; • Nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim; • Secili prej anëtarëve të KZAZ-zë, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën "pro" ose "kundër" si dhe arsyetimin përkatës; • Shoqërohen me mendimin e pakicës, nëse ka të tillë. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ nuk ka të drejtë vote; ✓ kryen zbardhjen e vendimit: <ul style="list-style-type: none"> • sipas modelit përkatës; • jo më vonë se 24 orë nga marrja e vendimit; • në numër kopjesh të barabartë me numrin e subjekteve të interesuara, dhe për t'u administruar në arkivin e KZAZ-së; ✓ i vulos me vulën e KZAZ-së.
! Vota e anëtarit të KZAZ-së që është në kushtet e konfliktit të interesit, por nuk është liruar nga detyra, është e pavlefshme dhe nuk llogaritet në kuorum.	
KZAZ-ja është e detyruar t'i bëjë publike vendimet e marra, të dërgojë kopje të tyre në KQZ dhe t'u japë subjekteve zgjedhore ose vëzhguesve të akredituar kopje të vërtetuara të tyre pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës.	
<i>* Brenda 24 orëve, Kryetari apo dy anëtarë të KZAZ-së, i dërgojnë Komisionerit për shqyrtim çështjen për të cilën KZAZ nuk ka arritur të marrë vendim brenda afatit përkatës. Vendimi i Komisionerit është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KZAZ-ja.</i>	

III.11 - Konflikti i interesit

- Anëtari i KZAZ-së është në kushtet e konfliktit të interesit, kur:
 1. Ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;
 2. Është në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumemërore të një partie apo koalicioni që konkuron në zonë;
 3. Nuk plotëson më kushtet për të qenë zgjedhës;
 4. Nuk është me vendbanimin në zonën zgjedhore;
 - Anëtari i KZAZ-së, që ka konflikt interesi:
 - ✓ Nuk mund të marrë pjesë në shqyrtim dhe marrjen e vendimit;
 - ✓ Duhet ta vetëdeklarojë këtë fakt, ose kjo bëhet nga çdo anëtar apo sekretari KZAZ-së që ka dijeni;
 - ✓ Në çdo rast, plotësohet dhe nënshkruhet një deklaratë ku pasqyrohen shkaqet e konfliktit të interesit;
- Deklarata administrohet nga sekretari i KZAZ-së, i cili njofton menjëherë Komisionerin. Njoftimit i bashkëngjitet kopja e deklaramit të anëtarit përkatës ose të anëtarit që ka dijeni për konfliktin e interesit.

III.12 - Ankimi ndaj vendimeve të KZAZ-së

Të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të KZAZ-së e ka:

Subjektet	Objekti i ankimit	Afatet	Organi që shqyrton ankimin
Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni	•Cënim i interesave të tyre të ligjshme;	3 ditë nga data shpallja e Vendimit	Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Kandidati i propozuar nga zgjedhësit	•Refuzim i kërkesës për akreditim të vëzhguesve.		

Ankuesi duhet të depozitojë, së bashku me ankimin edhe vendimin e plotë ndaj të cilit ushtrohet ankimi, me përjashtim të rastit kur KZAZ-ja nuk merr vendim.

Kërkesa ankimore duhet të përmbajë:

- ✓ Emrin e plotë të subjektit/individit ankues dhe adresën e tij;
- ✓ Bazën ligjore;
- ✓ Referimin të vendimi që ankimohet;
- ✓ Përshkrimin e shkurtër të shkeljes së pretenduar;
- ✓ Përshkrimin e fakteve, argumenteve dhe dispozitave ligjore të cilat ai mbështet ankimin;
- ✓ Tregimin e provave të cilat kërkon të marrë gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, si dhe burimin e tyre;
- ✓ Datën dhe firmën e ankuesit.

**Çdo vendim i KZAZ-së, i marrë gjatë procedurës së marrjes në dorëzim të materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor nga KQV-të, si dhe gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të votimit, janë vendime të ndërmjetme dhe ankimohen në KAS së bashku me ankimin kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore*

KREU IV - BASHKËPUNIMI, KOMUNIKIMI, NDËRVEPRIMI I KZAZ-së ME KQZ-në, KQV-në, POLICINË E SHTETIT, PARTITË POLITIKE, INSTITUCIONE DHE MEDIAN

IV.1 - Ndërveprimi KZAZ-së me KQZ-në

KZAZ mban të informuar Komisionerin, përmes administratës së KQZ-së, për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në ZAZ. Komunikimi bëhet në formë shkresore ose përmes adresës zyrtare të postës elektronike të KZAZ-së:

- ✓ Humbjen/dëmtimin e vulës së KZAZ;
- ✓ Vakancat në KZAZ;
- ✓ Mosmarrjen e vendimeve;
- ✓ Çdo problematikë të ndërtesave/ mjediseve, ku janë caktuar QV-të;
- ✓ Respektimin ose jo nga parti të politike të afateve për paraqitjen e propozimeve për anëtarë të KQV-ve, GNV-ve;
- ✓ Paraqitjen ose jo në trajnim/detyrë të anëtarëve të KQV-ve;
- ✓ Ecurinë e shpërndarjes së bazës materiale zgjedhore, sipas grafikut të miratuar nga KZAZ-ja dhe çdo problem gjatë këtij procesi;
- ✓ Qëndrime apo sjellje të vëzhguesve në shkelje të detyrave të tyre;
- ✓ Hapjen e QV-ve ditën e zgjedhjeve dhe mungesat e anëtarëve të KQV-ve, nëse ka;
- ✓ Dëmtimin apo nxjerrjen jashtë qendrës së votimit të vulës së KQV-së apo të Kryetarit të KQV-së, kryerjen e procedurave për zëvendësimin e saj, orën e kryerjes së tyre;
- ✓ Pezullimin dhe rifillimin e votimit në QV, shkaqet, masat e marra për rivendosjen e rendit në QV ose në rrethinat e QV-së, kohën e ndërprerjes dhe rifillimit të votimit;



- ✓ Numrin e QV-ve, të cilat mbyllin votimin në orën 19:00, dhe numrin e QV-ve, që nuk kanë përfunduar ende procesin, për shkak të zgjedhësve që presin në radhë për të votuar në këtë orar;
- ✓ Ecurinë e dorëzimit të materialeve të votimit.

IV.2 – Ndërveprimi i KZAZ-së me KQV-në

KZAZ, në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësive për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në ZAZ, monitoron veprimtarinë e KQV-ve nën juridiksion. Ka kompetenca për të siguruar funksionimin e tyre dhe mbarëvajtjen e procesit të votimit. Komunikimi KZAZ-KQV kryesisht ka të bëjë me:

- ✓ Njoffimin për trajnimin e anëtarëve të KQV-ve, zbatimin e detyrimit ligjor, në rastet e mospjesëmarrjes në trajnim;
- ✓ Njoffimin për paraqitjen në orën e caktuar në KZAZ, për tërheqjen e bazës materiale zgjedhore;
- ✓ Marrjen e informacionit për:
 - Praninë e punonjësit të Policisë së Shtetit, kur mbërrin baza materiale zgjedhore në QV (24 Prill 2021), dhe
 - Në ditën e zgjedhjeve:
 - Një orë para hapjes së votimit, paraqitjen e anëtarëve të KQV në QV përkatëse;
 - Në momentin e hapjes së QV-së, rezultatet e inventarizimit të bazës materiale zgjedhore;
 - Rastet kur në QV, ose në rrethinat e saj është cënuar rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit, orën e pezullimit dhe orën e rifillimit të votimit;
 - Orën e mbylljes së votimit dhe shoqërimin e materialeve të votimit në KZAZ.

IV.3 - Ndërveprimi i KZAZ-së me Policinë e Shtetit

Policia e Shtetit i ushtron detyrat e veta në shërbim të zgjedhjeve, në paanshmëri të plotë ndaj subjekteve zgjedhore, në përputhje me Kodin Zgjedhor, ligjin 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, si dhe dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e saj në raport me masat dhe mjetet në përdorim të saj.

KZAZ, për të garantuar zhvillimin e qetë dhe të rregullt të procesit zgjedhor në ZAZ, shkëmben informacion dhe komunikon menjëherë me Policinë e Shtetit për zbatim të detyrave të saj në shërbim të administrimit të zgjedhjeve.

Kryetari i KZAZ është përgjegjës për:	Sekretari i KZAZ është përgjegjës për:
Të njoftuar shefin e Komisarariatit të Policisë të njësisë së vetëqeverisjes vendore për vendndodhjen e KZAZ-së dhe orarin e punës së saj, <i>Jo më vonë se data 18 Prill 2021.</i>	Të dërguar në Policinë e Shtetit: <ul style="list-style-type: none">• grafikun e miratuar nga KZAZ-ja për dorëzimin e materialeve zgjedhore tek KQV-të;- emrat e Kryetarëve dhe Sekretarëve të KQV-ve dhe numrat e tyre të kontaktit.
Të dërguar në Komisariatin e Policisë të njësisë së vetëqeverisjes vendore grafikun e KZAZ-së për shpërndarjen e materialeve zgjedhore te KQV-të dhe dorëzimin e materialeve të votimit nga KQV-të në KZAZ, e cila përmban: <ul style="list-style-type: none">• listën e mjeteve të transportit,• llojin dhe targat e tyre, për çdo QV;• emrat e drejtuesve të mjeteve. <p><i>Grafiku dërgohet, i firmosur nga kryetari dhe zv.kryetari i KZAZ-së, i vulosur nga sekretari më vulën e KZAZ-së.</i> <i>Jo më vonë se data 18 Prill 2021</i></p>	Të bashkërenduar masat me Policinë e Shtetit për rendin publik në funksion të zgjedhjeve: <ul style="list-style-type: none">• dokumentimin në detaje në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, të rasteve të ndërhyrjeve të Policisë së Shtetit në mjediset ku kryhet administrim zgjedhor apo në rrethinat e tyre;• administrimin e dokumentacionit zyrtar për ndërhyrjet e Policisë së Shtetit në rivendosjen e rendit publik, kur<ul style="list-style-type: none">- jashtë qendrës së votimit rrezikohet rendi ose- pengohet procesi i rregullt i votimit.
Të kërkuar ndërhyrjen e Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin, kur në Selinë e KZAZ-së kanë mbërritur materialet zgjedhore dhe: <ul style="list-style-type: none">• në mjediset e oborrit të ndërtesës;• në hyrje dhe në korridoret e brendshme të ndërtesës, ka prani apo grumbullim të personave të tjerë, përveç personave të ngarkuar me detyra për administrimin zgjedhor ose vëzhguesit e akredituar nga KQZ/ KZAZ.	Të njoftuar: <ul style="list-style-type: none">- Drejtorin e Policisë Vendore dhe/ose- Shefin e Komisarariatit të Policisë që mbulon territorin ku ka vendndodhjen QV-ja, në mjedisin e së cilës është raportuar se <ul style="list-style-type: none">• rrezikohet rendi ose• pengohet procesi i rregullt i votimit. Anëtarët e KZAZ-së për rastin.

KZAZ-ja i drejtohet Drejtorit të Policisë Vendore, dhe njofton menjëherë KQZ-në, për probleme që mund të lindin dhe kanë të bëjnë me sjelljen dhe qëndrimin e punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë ushtrimit të detyrave në shërbim të zgjedhjeve.

IV.3 - Komunikimi i KZAZ-së me partitë politike

KZAZ komunikon me degët lokale të partive politike, të autorizuara, për:

- paraqitjen në afat të listës me kandidatura dhe dokumentacionin përkatës
 - të anëtarëve dhe sekretarë të KQV-ve;
 - të anëtarëve të grupeve të numërimit të votave;
- paraqitjen në afat të kandidaturës për plotësim të vakancave në KQV;
- njoftimin e vendit, datës dhe orës së trajnimeve, të përcaktuara nga KQZ;
- përgjigjet në kohë të kërkesave dhe ankesave të subjekteve zgjedhore dhe vëzhguesve të tyre.

IV.4 - Bashkëpunimi i KZAZ-së me institucionet shtetërore

KZAZ bashkëpunon me institucionet shtetërore në nivel lokal për:

• Marrjen në dorëzim të listës së zgjedhësve dhe afishimin e saj,	• Me njësinë e vetëqeverisjes vendore
• Përgatitjen e QV-ve dhe përshtatjen e mjediseve të tyre	• Me njësinë e vetëqeverisjes vendore
• Vënien në dispozicion të mjediseve të QV	• Me drejtoritë e institucioneve • arsimore dhe shëndetësore
• Vënien në dispozicion të ambienteve ku do të zhvillohen trajnime për administrim zgjedhor	• Me njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe drejtoritë e institucioneve arsimore

IV.5 - Komunikimi i KZAZ-së me Media

Mbulimi shumëplanësh mediatik i procesit zgjedhor, fokuson dhe pasqyron edhe veprimtarinë e komisioneve zgjedhore. Një javë para ditës së zgjedhjeve, gjatë ditës së zgjedhjeve, dhe procesit të numërimit të votave, mediat vizive të formatit info raportojnë në mënyrë të pandërprerë 24 orë, për të informuar opinionin publik.

KZAZ, në funksion të transparencës së organizmit dhe administrimit të procesit zgjedhor në ZAZ, bashkëpunon me mediat kombëtare apo lokale duke lehtësuar punën e gazetarëve për dhënien e informacionit me vërtetësi dhe paanësi.

KREU V - LISTA E ZGJEDHËSVE

V.1 - Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve

KZAZ-së i dërgohet, nga kryetari bashkisë jo më vonë se 21 Mars 2021, lista e zgjedhësve, në tre formate:

- ✓ Listë zgjedhësish në formë të printuar, e ndarë sipas qendrave të votimit:
 - përmban emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen dhe kodin e vendbanimit;
 - publikohet nga KZAZ-ja pranë çdo QV-je në një ambient me akses të lirë për zgjedhësit.
- ✓ Listë zgjedhësish në formë të printuar për përdorim nga KQV-ja në procesin e votimit:
 - e ndarë sipas qendrave të votimit.
 - përmban përbërësit zgjedhorë emrin, mbiemrin, datëlindjen, numrin personal të identifikimit, gjininë, hapësirën për shënimin e numrit të dokumentit të identifikimit dhe nënshkrimin nga vetë zgjedhësi gjatë votimit.
- ✓ Përmbledhje e të gjithë zgjedhësve në formë elektronike, e printuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në nivel ZAZ-je, sipas llojit të zgjedhjeve, që
 - përmban emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen dhe kodin e vendbanimit, e cila përdoret nga KZAZ-ja për informim të zgjedhësve.

V.2 - Pasaktësitë në listën e zgjedhësve

Zgjedhësi, kur vëren se:

- ✓ Përbërësit e tij zgjedhorë kanë pasaktësi;
- ✓ Nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij;
- ✓ Nuk është i regjistruar fare në ndonjë nga listat e zgjedhësve të ZAZ-së ku ka vendbanimin.

Ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa përjashtohet nga taksat gjyqësore.

Sekretari i KZAZ-së, me kërkesë të zgjedhësit, lëshon vërtetimin përkatës:

Model **KZAZ-15**, kur emri i zgjedhësit nuk gjendet në listat e zgjedhësve të ZAZ-së.

Model **KZAZ-16**, kur emri i zgjedhësit është i regjistruar në listën e zgjedhësve të kësaj ZAZ-je, por jo në zonën e qendrës së votimit të vendbanimit të tij.

KREU VI - VËZHguesIT

KZAZ pranon dhe shqyrton kërkesa për akreditimin e vëzhguesve të paraqitur nga::

Subjekti zgjedhor:	KZAZ	KQV	VNV
Partia politike që ✓ Nuk bën pjesë në asnjë koalicion; ✓ Është e regjistruar si subjekt zgjedhor dhe Ka paraqitur listë shumëemërore në KQZ.	1 vëzhgues	1 vëzhgues	1 vëzhgues për çdo tavolinë në VNV
Koalicioni i partive politike	3 vëzhgues	3 vëzhgues	3 vëzhgues për çdo tavolinë në VNV
Kandidati i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore përkatëse	1 vëzhgues	1 vëzhgues	1 vëzhgues për çdo tavolinë në VNV
! Kandidatët e partive politike nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.			

Kërkesa e subjektit zgjedhor për akreditim të vëzhguesve duhet të ketë bashkëngjitur:

- ✓ Listën e vëzhguesve që kërkohet të akreditohen pranë KZAZ/KQV/VNV të nënshkruar në çdo faqe nga kryetari i partisë/përfaqësuesi i koalicionit/kandidati i propozuar nga zgjedhësit, ose personi i autorizuar prej tyre, sipas modelit të përcaktuar nga KQZ.
- ✓ Vërtetimin që partia/koalicioni/kandidati i propozuar nga zgjedhësit është i regjistruar në KQZ dhe ka depozituar listat shumëemërore.
- ✓ Vetëdeklarimin e vëzhguesit për gjendjen gjyqësore.


Kërkesa për akreditimin e vëzhguesve dhe dokumentacioni përkatës mund të paraqiten nga personat e autorizuar nga kryetari i partisë/përfaqësuesi i koalicionit/kandidati i propozuar nga zgjedhësit. Akti i autorizimit depozitohet në KZAZ.

! Vëzhguesi duhet të plotësojë kushtet për të qenë zgjedhës si dhe të jetë i padënuar penalisht.

Paraqitja e kërkesës së subjektit zgjedhor në KZAZ për akreditim të vëzhguesve dhe afatet ligjore:

Paraqitja e kërkesës	Jo më vonë se 10 Prill 2021
Merr vendim për: <ul style="list-style-type: none"> • Akreditimin e vëzhguesve; • Refuzimin e kërkesës. 	Jo më vonë se 15 Prill 2021
Procedura, kur KZAZ vendos për: <ul style="list-style-type: none"> -Kthimin e dokumentacionit të paraqitur me mangësi në përmbajtje ose në formë; -Riparaqitjen e dokumentacionit të plotësuar pranë KZAZ-së, brenda 24 orëve nga njoftimi. <p style="text-align: center;"><i>*Verifikimi i qytë i dokumentacionit të riparaqitur pas plotësimit, kryhet nga KZAZ-ja brenda 24 orëve nga ridedepozitimi i tij.</i></p>	
* Kundër vendimit të KZAZ-së për refuzimin e kërkesës për akreditim të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore mund të bëhet ankim në KAS brenda tri (3) ditëve nga shpallja e vendimit.	

Vëzhguesi i miratuar me vendim nga KZAZ-ja:



✓ Pajset nga sekretari i KZAZ-së me autorizimin përkatës, sipas modelit të miratuar me vendim të KQZ-së;

✓ Mund të kryejë vëzhgime vetëm në ambientet zgjedhore të përcaktuar në autorizimin e KZAZ-së.

Autorizimi i lëshuar nga KZAZ:

✓ Është i vlefshëm për vëzhgim në KZAZ/QV/VNV të ZAZ-së përkatëse;

• I jep vëzhguesit të drejtën të hyjë dhe të qendrojë në mjediset e tyre, duke respektuar të drejtat dhe detyrat që u njeh Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së.

Të drejtat e vëzhguesit:

- ✓ Të vëzhgojë pa pengesë të gjitha aspektet e procesit zgjedhor vetëm në mjediset zgjedhore të përcaktuara në autorizimin e KZAZ-së apo të KQZ-së;
- ✓ Të paraqesi vërejtje me shkrim para komisioneve zgjedhore për çdo lloj parregullsie që vëren;
- ✓ Të shohë ose të këqyr dokumentacionin dhe materialet zgjedhore.

Detyrat e vëzhguesit:

- ✓ Të respektojë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe vendimet dhe urdhërimet e KZAZ-së, ku është akredituar;
- ✓ Të paraqesë para komisioneve zgjedhore autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja ose KZAZ-ja, të shoqëruar me dokument identifikimi të vlefshëm (pasaportë, kartë identiteti/letërnjoftimi);
- ✓ Të veprojë në mënyrë të paanshme, të mos bëjë propagandë për asnjë kandidat, parti politike apo koalicion në mjediset zgjedhore ku vëzhgojnë;
- ✓ Të mos mbajë simbole që shërbejnë si propagandë;
- ✓ Të mos çenojë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi;
- ✓ Të mos pengojë procesin e votimit, administrimit të zgjedhjeve dhe numërimit të votave;
- ✓ Të mos komentojë dhe mos të debatojë vendimet e KZAZ-së, KQV-së dhe GNV-ve;
- ✓ Të respektojë rregullat e etikës në marrëdhëniet me komisionerët zgjedhorë dhe vëzhguesit e tjerë.

! Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të akredituar në VNV janë të detyruar të qendrojnë në vendin e caktuar për ta nga KZAZ-ja

KZAZ dhe vëzhguesit të jenë rigorozë në zbatimin e masave anticovid-19, sipas rregullave e udhëzimeve të ekspertëve të Ministrisë së Shëndetësisë.

KREU VII - DETYRAT E KZAZ-së PËR NGRITJEN E KQV-ve

VII.1 - Përbërja e KQV-së

Të drejtën për të paraqitur propozime për anëtarë të KQV-ve, e kanë partitë politike të cilat kanë propozuar anëtarë të KZAZ-së, sipas përbërjes së KZAZ-së. Partitë politike paraqesin propozimet dhe dokumentacionin përkatës për anëtarë të KQV-ve, jo më vonë se **data 26 Mars 2021**.

KZAZ-ja, jo më vonë se **data 16 Mars 2021**, cakton partinë politike që do të propozojë anëtarin e shtatë të KQV-ve të Qendrave të Votimit, sipas procedurës së mëposhtme:

- ✓ Rendit të gjithë QV-të nën juridiksion territorial të ZAZ-së, sipas numrit të tyre unik në rend rritës, duke u nisur nga QV-ja me numër më të vogël. QV-të, numërtimi të cilave është me fraksion, renditen pas QV-së së origjinës.

Numërtimi i QV të renditura	Në QV-të e numërtuara me numër tek në renditje, anëtari i shtatë i KQV-së përkatëse propozohet nga partia (PS) që ka propozuar zv.kryetarin e KZAZ-së	Në QV-të e numërtuara me numër çift në renditje, anëtari i shtatë i KQV-së përkatëse propozohet nga partia (PD) që ka propozuar kryetarin e KZAZ-së
1. QV nr. 3502		
2. QV nr. 3503		
3. QV nr. 35031		
4. QV nr. 3504		
	1. QV nr. 3502 3. QV nr. 35031	2. QV nr. 3503 4. QV nr. 3504

- ✓ KZAZ-ja, menjëherë, njofton partitë politike përkatëse për paraqitjen e propozimeve për anëtarin e shtatë të KQV-ve.
- ✓ Kryetari dhe Sekretari i KQV-së zgjidhen nga KZAZ-ja.
Në KQV-të ku anëtari i shtatë i përket Partisë Socialiste, kryetar i KQV-së zgjidhet njëri nga anëtarët propozuar nga PS.
Në KQV-të ku anëtari i shtatë i përket Partisë Demokratike, kryetar i KQV-së zgjidhet njëri nga e anëtarët propozuar nga PD.
- ✓ Sekretari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.
- ✓ KZAZ-ja emëron anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve jo më vonë se data 31 Mars 2021, pasi ka verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga partitë politike.
- ✓ Në çdo rast emërimi i kryetarit dhe sekretarit bëhet jo më vonë se data 4 Prill 2021.

VII.2 – Paraqitja e kandidaturave për anëtarë të KQV-ve:

Partitë politike mund të autorizojnë degët lokale për paraqitjen e kandidaturave për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve.

- ✓ Autorizimi:
 - Paraqitet i nënshkruar nga kryetari i partisë politike dhe i vulosur me vulën e partisë;
 - Përcakton numrin e KZAZ-së apo KZAZ-ve, ku dega lokale e partisë politike do të paraqesë kandidaturat për anëtarë të KQV-ve;
 - Depozitohet në KZAZ së bashku me listën dhe dokumentacionin për kandidatura për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve.
- ✓ Për çdo kandidaturë, në listë pasqyrohet emri, atësia, mëmësia, mbiemri, datëlindja, gjinia, arsimi, numri telefonik i kontaktit;
- ✓ Për çdo kandidaturë të propozuar, bashkëlidhur listës paraqitet dokumentacioni:
 - Certifikatë personale e lëshuar nga zyra e gjendjes civile, ose nga portali e-albania;
 - Deklaratë e nënshkruar e kandidatit, përmes së cilës deklaron se:
 - a. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - b. nuk ka marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;
 - c. nuk është në marrëdhënie pune me ndonjë nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;
 - d. ka arsimin të mesëm apo të lartë.
- ✓ Si rregull, sekretari i KQV-së duhet të ketë arsimin e lartë.

Kushtet për emërimin e anëtarit të KQV-së:

- ✓ Gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
- ✓ Ka të paktën arsimin e mesëm;
- ✓ Është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
- ✓ Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- ✓ Ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.
- ✓ Sekretari i KQV-së, si rregull, ka arsimin e lartë.

Anëtari dhe sekretari i KQV-së nuk mund të jenë:

- ✓ Deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
- ✓ Kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
- ✓ Ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror; ose
- ✓ Anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Anëtari dhe sekretari i KQV-së lirohen nga detyra me vendim të KZAZ-së, kur

- ✓ Kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore;
- ✓ Janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve që konkurojnë në zonë;
- ✓ Japin dorëheqje;
- ✓ Nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës.

Anëtari dhe sekretari i KQV-së shkarkohen nga detyra me vendim të KZAZ-së, kur:

- ✓ Shkelin dispozitat e Kodit Zgjedhor ose aktet nënligjore, të KQZ & KZAZ, në zbatim të tij;
- ✓ Dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- ✓ Nuk paraqiten në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se dy ditë rresht;
- ✓ Nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ.

VII.3 - Procedura për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KQV-së

KZAZ:

Verifikon plotësimin e kushteve për emërimin anëtar dhe sekretar të KQV-së;	brenda 3 ditëve nga dorëzimi i kandidatuarave
Njofton partitë politike për mangësi të propozimeve apo dokumentacionit të paraqitur;	brenda 3 ditëve nga dorëzimi i kandidatuarave
Pranon dokumentacionin e riparaqitur nga partia politike.	brenda 24 orëve nga njoftimi i KZAZ-së për mangësi të paraqitjes së propozimeve/dokumentacionit

VII.4 - Vakancat në KQV dhe plotësimi i tyre

Kur vendi i një anëtari ose sekretari të KQV-së mbetet vakant, ai plotësohet:

- ✓ Brenda 3 ditëve, por jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë para hapjes së procesit të votimit;
- ✓ Jo më vonë se 2 orë nga njoftimi i mungesës, në ditën e zgjedhjeve (larguar ose që nuk paraqiten në detyrë).
- ✓ Sekretari i KZAZ-së
- Njofton menjëherë degën lokale të partisë përkatëse:
 - Për krijimin e vakancës në KQV-në dhe afatin për dorëzimin e propozimit dhe dokumentacionit të kandidaturës zëvendësuese;
 - Shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së:
 - a. Datën dhe orën e njoftimit, si dhe numrin e QV-së ku është njoftuar vakanca;
 - b. Emrin e anëtarit të KQV-së që ka krijuar vakancë, partinë politike që e ka propozuar;
 - c. Emrin e anëtarit që njoftoi KZAZ-në.
- ✓ Zëvendësimi i anëtarëve të KQV-së bëhet si rregull me persona, të cilët kanë trajnim për legjislacionin zgjedhor.

VII.5 - Plotësimi kryesisht i vakancave në KQV

KZAZ-ja, kur KQV-ja ka mbetur pa kuorum, 24 orë para hapjes së procesit të votimit, ose në ditën e zgjedhjeve, për shkak të mosparaqitjes në detyrë të anëtarëve apo largimit të tyre, kur nuk është kryer zëvendësimi sipas afateve:

- ✓ Urdhëron menjëherë KQV-në përkatëse të vazhdojë procedurat dhe merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës;
- ✓ Emëron kryesisht anëtarët e KQV-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje, me emra nga lista e miratuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

KZAZ, organizon në seancë publike hedhjen e shortit, për përzgjedhjen e shtetasve nga lista e miratuar me vendim të Komisionerit, në rastet, kur:

- ✓ Numri i shtetasve në listën e miratuar është më i madh se numri KQV-ve që kanë vakancë;
- ✓ Në ZAZ ka më shumë se një KQV që ka vakancë.

Ora, data dhe vendi i hedhjes së shortit shpallen në hyrje të Selisë së KZAZ-së, dhe njoftohen shtetasit që do të marrin pjesë në short përmes postës elektronike dhe komunikimit telefonik.

Mosparaqitja e shtetasve, **pasi njoftimet janë publikuar**, nuk pezullon procedurat e shortit.

KZAZ organizon hedhjen e shortit sipas procedurës:	
Numri i shtetasve në listën e miratuar është më i madh se numri i KQV-ve, që kanë vakancë;	Në ZAZ ka më shumë se një KQV që ka vakancë;
Në një enë transparente futen aq gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë sa është numri i shtetasve në listën e miratuar.	Liston të gjitha QV-të, KQV-të e të cilave janë pa kuorum, duke i renditur nga QV-ja me numër më të vogël dhe duke vazhduar në rend rritës; QV-të bija renditen pas QV-së së origjinës.
Në secilën prej goglave mbyllet nga një shirit letre, ku shënohet emri i shtetasit pjesëmarrës në short.	QV-të e renditura, numërtohen nga KZAZ-ja duke filluar nga numri 1 e duke vazhduar në rend rritës deri në numërtimin e QV-së së fundit pa kuorum.
Sekretari i KZAZ-së: <ul style="list-style-type: none"> • Tërheq nga ena njëren nga goglat, • E hap, • Lexon emrin e shtetasit që është shënuar në shiritin brenda goglës, dhe • Ia dorëzon shiritin KZAZ-së. 	Në një enë transparente futen aq gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë sa është numri i shtetasve në listën e miratuar nga KQZ-ja. Në secilën prej goglave mbyllet nga një shirit letre ku shënohet emri i shtetasit pjesëmarrës në short. Sekretari i KZAZ : <ul style="list-style-type: none"> • Tërheq nga ena, me radhë, aq gogla sa është numri i KQV-ve që janë pa kuorum në ZAZ-në përkatëse; • Hap goglat, lexon emrin e shtetasit që është shënuar në shiritin brenda goglës; • Ia dorëzon shiritin KZAZ-së; Emrat e shtetasve, sipas radhës së shortit të tërhequr i korrespondojnë KQV-së që ka vakancë, sipas numërtimit të kryer nga KZAZ-ja.

KZAZ-ja, në përfundim të procedurës, me vendim, emëron kryesisht anëtarin apo sekretarin e KQV-së, sipas rezultatit të shortit.

VII.6 - KQV-të E POSAÇME

- ✓ "Institucione të posaçme" janë burgjet, vendet e paraburgimit dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore,
- ✓ Institucionet e posaçme që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë, përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi.

**Qendra e votimit në këto institucione ngrihet, kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës.*


- ✓ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore njofton menjëherë KQZ dhe KZAZ-në për ngritjen e QV-ve në institucione të posaçme, llojin e institucionit, dhe numrin e zgjedhësve.
- ✓ KZAZ-ja, i propozon KQZ-së krijimin e KQV-ve të posaçme në institucionet e posaçme.

** Këto komisione kanë të njëjtën përbërje dhe të njëjtat përgjegjësi si edhe KQV-ja.*

VII.7 - Qendra e votimit

Mjedisi i qendrës së votimit:

- ✓ Si rregull, duhet të jetë me sipërfaqe jo më të vogël se 30 m² dhe të jetë me ndriçim të mjaftueshëm;
- ✓ Duhet të jetë e pajisur me tavolina, karrige apo pajisje të tjera, të mjaftueshme për anëtarët e KQV-së dhe vëzhguesit, sipas skemës tip të planvendosjes, jo më vonë se 48 orë përpara ditës së zgjedhjeve.



KZAZ:
✓ Kryen

verifikime dhe informon KQZ-në, në rastin kur Kryetari i Bashkisë i propozon KQZ-së caktimin e vendndodhjes së QV-së në ndërtesë private;

- ✓ Bashkëpunon me KQZ-në për instalimin e video: monitorimit në qendrat e votimit, në mënyrë të fillë që të mos çenojë ose të rrezikojë kryerjen në fshehtësi të votimit.

KREU VIII – ORGANIZIMI DHE PËRGATITJA E VNV-SË

VNV caktohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve.

KZAZ-ja, në bashkëpunim me organet e vetqeverisjes vendore, merr masa për:

- ✓ Krijimin e kushteve të përshtatshme,
- ✓ Ndjek dhe monitoron procesin e instalimit e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

! Kamerat me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë që në monitor fleta e votimit të shfaqet e plotë dhe të realizohet qartë:

- Regjistrimi video i vlerësimit të çdo flete votimi, dhe
- Regjistrimi video i numërimit të fletëve të votimit.

Monitorët:

- Vendosen përballë hapësirës ku qëndrojnë vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, dhe
- Transmetojnë në kohë reale regjistrimin filmik të numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit.

VIII.1 - Përgatitja e VNV-së

KZAZ-ja, jo më vonë se dhjetë ditë para datës së zgjedhjeve,

- Organizon dhe përgatit VNV në mënyrë të tillë që të garantohet zhvillimi i qetë, i rregullt dhe në transparencë të plotë i procesit të numërimit të votave.
- Vendos,
 - ✓ Për çdo grup numërimi, tavolinë numërimi/tavolina pune me hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procedurave të numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit,
 - ✓ Tavolinat e numërimit për grupet e numërimit dhe vendin e anëtarëve të KZAZ-ve në të njëjtën mjedis ku kryhet procesi i numërimit të votave.
 - ✓ Tavolinat e numërimit në mënyrë të tillë që të shikohen pa asnjë pengesë nga anëtarët e KZAZ-së, vëzhguesit e akredituar, kandidatët dhe përfaqësuesit e medias.

Një VNV nuk mund të ketë më pak se tre dhe më shumë se dhjetë tavolina të numërimit të votave.


KZAZ-ja vendos në VNV, sipas kriterëve për caktimin e Tavolinave të Numërimit të Votave:

VNV-të vihen në dispozicion të KZAZ-ve jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve.

Tavolina	Numri i QV-ve
Jo më pak se 3	30
Jo më pak se 4	Nga 31-50
Jo më pak se 5	Nga 51-80
Jo më pak se 6	Nga 81-100
Jo më pak se 7	Nga 101-115
Jo më pak se 8	Nga 116-130
Jo më pak se 9	Nga 131-140
10	Mbi 140

VIII.2 - Organizimi i VNV-së, skema organizative e funksionimit të VNV

Skema organizative e funksionimit të VNV-së, do të jetë sipas planvendosjes tip në lidhjen 1, duke respektuar kriteret:



- Hapësira ku vendosen tavolinat e numërimit:
 - të jetë e mjaftueshme, duke siguruar vendosjen e tyre në distancë dhe të barazlanguar nga njëra-tjetra;
 - të jetë përballë hapësirës ku qëndrojnë vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore, vëzhguesit e akredituar nga KQZ, kandidatët dhe mediat;
 - të jetë e ndarë qartë nga hapësira ku qëndrojnë vëzhguesit e akredituar, kandidatët dhe mediat.
- Hapësira në dispozicion të çdo GNV:
 - të shmangë çdo mundësi për kontakt fizik të personave të pranishëm në VNV me materialet e votimit;
 - të jetë e mjaftueshme për tavolinën e numërimit, kutinë e votimit dhe/ose kutinë e materialeve të votimit që vendosen pranë saj, si dhe për karrige për çdo anëtar të GNV;
 - të mundësojnë instalimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin dhe vlerësimin e votave.

- c) Hapësira ku do të vendosen kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit që merren në dorëzim nga Komisionet e Qendrave të Votimit, si dhe hapësira ku ato do të vendosen pas numërimit:
- të jenë në të njëjtin mjedis ku kryhet numërimi i votave;
 - të jenë të garantuara nga çdo ndërhyrje e personave të paautorizuar.
- ç) Hapësira ku do të qëndrojnë vëzhguesit e akredituar:
- të jetë përballë dhe në largësi të vogël nga hapësira ku vendosen tavolinat e numërimit;
 - të jetë në distancë jo më pak se një metër e gjysëm nga monitorët kur përdoret teknologjia mbështetëse për numërimin e votave;
 - në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk duhet cënuar mundësia e vëzhguesve për të ndjekur nga afër procesin e numërimit të votave dhe shfaqjen e fletëve të votimit në monitorët e vendosur, për këtë qëllim.
- d) Vendi ku do të afishohen kopje të tabelës së rezultatit të qendrave të votimit, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, kopje të tabelës përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së:
- të caktohet pranë hapësirës ku qëndrojnë vëzhguesit e akredituar;
 - të shikohet pa asnjë pengesë nga të gjithë vëzhguesit e akredituar.

VIII.3 - Prezantimi i Vendit të Numërimit të Votave

KZAZ-ja, jo më vonë se se data 20 Prill 2021:

- kryen organizimin dhe sistemimin e VNV-së,
 - ✓ me pajisjet logjistike të siguruara në bashkëpunim me pushetin vendor, dhe pajisjet e dërguara nga KQZ (Tabela 1):

Tabela 1

	Tavolina pune	Karrige	Kompjuter	Printer	Fotokopje	Skaner	Linjë Telefonike
KZAZ	2	8	1	1	1	1	1
Ndihmësi teknik	1	2					
Për çdo GN	2	4					

- tavolinë pune dhe 8 karrige për KZAZ-në;
- tavolinë pune dhe 2 karrige për ndihmësit teknik;
- tavolinë numërimi për çdo GNV, që krijohet duke bashkuar dy tavolina pune, dhe katër karrige për çdo tavolinë numërimi të votave;
- shenjën, në sipërfaqen e tavolinës së numërimit, e cila gjatë regjistrimit në kamër evidenton qartësisht numrin e grupit të numërimit dhe numrin e qendrës së votimit që numërohet;
- kompjuter, printer, fotokopje, skaner dhe linjë telefonike për KZAZ-në;
- kamerat rregjistruese të montuara mbi çdo tavolinë numërimi;
- monitorët të vendosur për çdo tavolinë numërimi;
- strukturat ndarëse të hapësirës së vëzhguesve, kandidatëve dhe mediave me hapësirën për numërimin e votave;
- ka vendosur pranë çdo tavoline numërimi tabela identifikuese me numrin përkatës për çdo GNV;
- ka vendosur në hyrje të objektit ku është vendosur VNV, tabelën identifikuese të VNV-së me numrin përkatës të ZAZ-së;

- ka vendosur shenja orientuese për drejtimin e lëvizjes në mjediset e brendshme të VNV.
- Fton për njohje të VNV subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve.

! Në çdo rast, organi që administron objektin ku është vendosur VNV-ja,

bashkëpunon për sigurimin e:

- pajisjeve logjistike të parashikuara në paragrafët e mësipërm dhe
- pajisjeve me mjete të mbrojtëse kundra zjarrit si dhe ato të ndihmës së shpejtë.

Mjedisi ku caktohet VNV duhet të ketë, për aq sa është e mundur, më shumë se një derë komunikuese me mjedisin e jashtëm.

KREU IX - DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KQZ NË KZAZ

IX.1 - Materiale zgjedhore që KZAZ merr në dorëzim nga KQZ

A. Materiale zgjedhore paraprake:

- Vula e KZAZ-së;
- Dokumentacioni i punës së KZAZ-së:
Libër Protokollit, Regjistër Korrespondence, Regjistër vendimesh, Procesverbal Konstatimi.
- Kod Zgjedhor, vendime, udhëzime të KQZ-së.

Këto materiale dorëzohen në ditën e ngritjes së KZAZ-ve, me procesverbal Model **KZAZ 18** "Për pajisjen e KZAZ-së me materiale për administrimin e zgjedhjeve".

- B. Materialet zgjedhore, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve, të ndara në kuti të veçanta. dërgohen nga KQZ në KZAZ:

B.1. Materiale zgjedhore për çdo qendër votimi, sipas procesverbaleve:

- Model **KZAZ 21** "Për dorëzimin e fletëve të votimit për çdo Qendër Votimi të ZAZ":
- ✓ Numrin e nevojshëm të fletëve të votimit, në përputhje me numrin e zgjedhësve të regjistruar në atë qendër votimi, së bashku me fletët shtesë. Si rregull fletët dorëzohen të paketuara në blloqe prej 100 fletësh, së bashku me dokumentin që tregon serinë përkatëse të bllokut të fletëve.

Ndërsa bazuar në:

- Model **KZAZ 20** "Për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për KQV-të e ZAZ-së" dorëzohen:

- ✓ Vula e KQV-së;

! Vulat e KQV-ve, secila veçmas, të paketuara me ambalazh sigurie

- Numrin e nevojshëm të vulave të kryetarëve të KQV-ve, të paketuara me ambalazh sigurie, secila veçmas.

! Vulat për kryetarët e KQV-ve dërgohen në numër të barabartë me numrin e KQV-ve të KZAZ-së përkatëse.

- Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së;
- Procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë edhe formularët tip të procesverbaleve dhe të vendimeve për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, kërkimin e ndihmës së policisë dhe të largimit të saj, si dhe mbylljen e votimit;
- Zarfë në të cilin është shënuar "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA";
- Zarfë në të cilin është shënuar "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA";
- Zarfë në të cilin është shënuar "ZARFI I PROCESVERBALIT TË VULOSJES"; dhe
- Lënda e posaçme për timbrimin e zgjedhësit(Bojë matrikuluese) dhe aparatit verifikues të saj.
- Kuti votimi për çdo qendër votimi;
- Numër i mjaftueshëm kodesh sigurie, për çdo qendër votimi;
- Numër i mjaftueshëm dhomash të fshehta, për çdo qendër votimi:
 - një dhomë të fshehtë dhe
 - një dhomë, tjetër, të fshehtë për personat me aftësi të kufizuara;
- Kopje të mjaftueshme të Kodit Zgjedhor dhe të manualeve zgjedhore;
- Mjete të tjera të nevojshme për procesin e votimit.

B.2. - Materialet zgjedhore që përdoren nga grupet e numërimit të votave, të cilat dorëzohen me procesverbal Model **KZAZ 19 "Për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për procesin e numërimit të votave":**

- ✓ Model GNV 1 "Për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara të QV-së"
- ✓ Model GNV 2 "Për mbylljen e kutisë së materialeve zgjedhore të QV-së;
- ✓ Tabelat e rezultateve që plotësohen nga GNV-të për nxjerrjen e rezultatit të QV-së;
- ✓ Set i zarfave të sigurisë (Z-04, Z-05, Z-06, Z-07)
 - Zarfë i fletëve të votimit të vlefshme për çdo subjekt zgjedhor Model Z06;
 - Zarfë i fletëve të votimit të kontestuara, Model Z04;
 - Zarfë i fletëve të votimit të pavlefshme, Model Z05;
 - Zarfë i fletëve të votimit të kandidatit të parapëlqyer, Model Z07.
- ✓ Vula me kod sigurie për GNV-të;
- ✓ Vula me kod sigurie rezervë/shtesë për GNV-të;
- ✓ Makinë llogaritëse;
- ✓ Pincë për këputjen e vulave me kode të sigurisë.

Materiale të inventarizuara

- ✓ Shirit ndarës për VNV-në;
- ✓ Bazament për identifikimin e GN-së;
- ✓ Element ndarës për organizimin e VNV-së.

Cjithashtu, punonjësi i KQZ-së i dorëzon KZAZ-së edhe:

- ✓ Tabelë përmbledhëse të Rezultateve (që plotësohet nga KZAZ-ja)
- ✓ Tabela identifikuese e QV-së;

- ✓ Tabela identifikuese e VNV-së;
- ✓ Shenjë dalluese për GN-të;
- ✓ Dokument identifikimi për anëtarët e KQV-ve dhe GNV-ve;
- ✓ Stilolaps;
- ✓ Letër, format A4.

! Materiale zgjedhore dorëzohen nga KQZ në KZAZ, me procesverbalet:

Model **KZAZ 19** "Për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për procesin e numërimit të votave".

Model **KZAZ 20** "Për pajisjen e KZAZ me materiale zgjedhore për KQV-të e ZAZ-së".

Model **KZAZ 21** "Për dorëzimin e fletëve të votimit për çdo Qendër Votimi të ZAZ"

IX.2 - Materiale zgjedhore që KZAZ-ja i dorëzon çdo KQV-je

KZAZ:

- ✓ Njoffton çdo KQV për kohën e marrjes së materialeve zgjedhore, duke patur parasysh largësinë e saj nga vendndodhja e KZAZ-së;
- ✓ Sigurohet për gatishmërinë e mjeteve të planifikuara për transportin e materialeve zgjedhore për çdo KQV;
- ✓ Në rast të defekteve apo problemeve, merr masa për zëvendësimin e mjetit dhe kryen menjëherë njofftimin në Komisarjatin e Policisë për emrin e drejtuesit, targën dhe llojin e mjetit;
- ✓ Shpërndan materialet zgjedhore për çdo QV në juridiksionin e saj
**jo më vonë se ora 15⁰⁰ e datës 24 Prill 2021;*
- ✓ Dorëzimi i materialeve të votimit për KQV dokumentohet në **procesverbalet**:
Model KZAZ 22 "Për pajisjen nga KZAZ me materiale zgjedhore të KQV-së".



Bojë matrikulluese



Kutia e votimit



Kutia e materialeve zgjedhore

IX.3 - Materiale zgjedhore jashtë kutisë, të cilat i dorëzohen KQV-së nga KZAZ-ja:

- ✓ **Lista e zgjedhësve**, dorëzohet me procesverbal të përgatitur nga KZAZ-ja;
- ✓ **Vulat me kode sigurie**, gjithsej 12, dorëzohen me procesverbal Model KZAZ 23 "Për pajisjen e KQV nga KZAZ me vula me kode të sigurisë":



- Nëntë vula me kode sigurie me trup plastik me ngjyrë të bardhë, ku është stampuar kodi i sigurisë:

- a. Pesë vula me kode sigurie do të përdoren për mbylljen e kutisë së votimit;
- b. Katër vula me kode sigurie do të përdoren për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit.



- Tre vulat shtesë me kod sigurie, që do të përdoren, **vetëm**, në rast të dëmtimit të vulave me ngjyrë të bardhë, për mbylljen e kutisë së votimit me fletët e votimit dhe kutisë së materialeve të votimit, Vulat shtesë me kod sigurie kanë trupin plastik me ngjyrë të verdhë, ku është stampuar kodi i sigurisë.

Kodi i sigurisë është unik për çdo vulë, përbëhet nga 3 (tri) shkronja, KQZ, dhe një numër unik gjashtë shifror.



- ✓ **Vula e KQV-së.**



- ✓ **Vula për Kryetarin e KQV-së**, e vendosur në një zarf, të mbyllur të vulosur.

IX.4 - Procedura për dorëzimin e vulës së kryetarit të KQV-së

- ✓ Kryetari i KQV-së përkatëse, në praninë e anëtarëve të KZAZ-së, kryen sipas radhës veprimet e mëposhtme:
 - Merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave të paketuara;
 - Gris ambalazhin e vulës;
 - Vulos, në një letër të bardhë, modelin e krahasimit të vulës;
 - Shënon me shkrim dore emrin dhe mbiemrin e tij, poshtë modelit të krahasimit të vulës dhe nënshkruan.
- ✓ Anëtarët e KZAZ-së nënshkruajnë në pjesën e pasme të letrës së bardhë me modelin krahasues (specimenin) të Vulës së Kryetarit të KQV-së.



- ✓ Letra e bardhë me modelin krahasues të vulës, ku Kryetari i KQV dhe anëtarët e KZAZ depozituan nënshkrimet, mbahet në ruajtje nga Sekretari i KZAZ-së në një dosje të veçantë, së bashku me modelin **KZAZ-23, Model KZAZ-22 dhe** procesverbalin "Për marrjen në dorëzim të listës së zgjedhësve" të KQV-së përkatëse.

! TË GJITHA MODELET E PROCESVERBALEVE I GJENI NË FLETORËN E PUNËS SË KZAZ-SË

KREU X - DITA E ZGJEDHJEVE

X.1 - Ndjekja dhe monitorimi i procesit zgjedhor

KZAZ-ja, para dites se zgjedhjeve, harton planin për ndjekjen dhe monitorimin e procesit zgjedhor në të gjitha QV-të e përfshira në territorin ZAZ-së:

Në ora 6:00,

sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet e KQZ-së, zgjidh probleme të njoftuara nga KQV-të për:

- Mos paraqitjen e anëtarëve të KQV-së në QV;
- Materialet zgjedhore, sipas inventarizimit të kryer nga KQV-ja;
- Mosdakortësi të anëtarëve të KQV-ve gjatë kryerjes së procedurave për fillimin e votimit.

Në orën 7:00

Informohet për fillimin e procesit të votimit në të gjitha QV-të e ZAZ-së, dhe vepron për të shmangur çdo vonesë.

Nga ora 7:00-19:00

Informohet për ecurinë e procesit të votimit, rastet e pezullimit të votimit, në vlerësim të situatës, dërgon anëtarë të KZAZ-së për të shmangur problematikën dhe rifilluar sa më parë procesin e votimit.

Plotëson vakancat në KQV brenda dy orëve nga njoftimi dhe/ose urdhëron KQV-në për të vijuar punën nën kuorum, kur vakanca nuk plotësohet brenda afatit.

Verifikon informacionin dhe njofton menjëherë Policinë e Shtetit për të rivendosur rendin publik kur:

- Në mjediset jashtë QV-së, në hyrje, oborr, ambientet përçark oborrit të ndërtesës dhe rreth saj në një rreze prej 150 m nga QV; përveç zgjedhësve që presin në radhë për të votuar, ka prani apo grumbullime të personave që nuk janë të ngarkuar me kryerjen e sondazheve për votimin nga një organizatë e autorizuar për këtë qëllim nga KQZ-ja.

Verifikon që vendintervistimi i votuesve, për llogari të sondazheve nga organizata të autorizuar për këtë qëllim nga KQZ-ja, bëhet:

- Në rrethinat e jashtme të ndërtesës, me shenja të qarta dalluese dhe shpjeguese,
- pa penguar në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak kalueshmërinë dhe hyrje-daljen e lirë të zgjedhësve në QV;

U përcjell menjëherë organeve të Policisë së Shtetit kërkesën e KQV-së për ndërhyrjen e Policisë së Shtetit për rivendosjen e rendit dhe zhvillimin e rregullt të votimit;

Me marrjen e njoftimit nga KQV-ja për dëmtim apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës së KQV-së, apo të vulës së Kryetarit të KQV-së, Sekretari i KZAZ-së:

- Shënon në LPM numrin e QV-së, orën dhe rrethanat e njoftuara nga KQV-ja përkatëse, llojin e vulës, e cila kërkohet të zëvendësohet, emrin dhe pozicionin e anëtarit të KQV-së, që bëri njoftimin.
- Njofton menjëherë anëtarët e KZAZ-së dhe Komisionerin, përmes administratës së KQZ-së;
- Paraqet kërkesë për nxjerrjen nga përdorimi të vulës së KQV-së ose vulës së Kryetarit të KQV-së përkatëse, dhe zëvendësimin e saj me vulë rezervë.
- **KËRKESA:**
 - përmban numrin e KQV-së, orën dhe rrethanat e njoftuara nga KQV-ja, llojin e vulës që kërkohet të zëvendësohet, numrin serial në rastin e vulës së Kryetarit të KQV-së, emrin dhe pozicionin e anëtarit të KQV-së që kreu njoftimin;
 - paraqitet me shkrim, firmoset nga Sekretari i KZAZ-së dhe sipas rastit nga Kryetari dhe/ose Zv.kryetari i KZAZ-së, vuloset me vulën e KZAZ-së dhe dërgohet përmes rrugëve elektronike të komunikimit.
- Shënon në LPM orën e marrjes në dorëzim të vulës rezervë nga KQV-ja përkatëse, dhe emrin e nëpunësit të KQZ-së, që kreu dorëzimin;

Nga ora 19:00 deri në ora 22:00

Informohet për:

- Mbylljen e votimit në QV-të nën juridiksion;
- Numrin e QV-ve që ka zgjedhës në radhë për të votuar;
- Ecurinë e procedurave të mbylljes së votimit nga KQV-të;
- Shoqërimin e materialeve të votimit në VNV, jo më vonë se ora 22:00.

X.2 - Marrja në dorëzim e materialeve të votimit

Ngritja e Grupeve të marrjes në dorëzim të materialeve të votimit

KZAZ-ja, për marrjen në dorëzim të materialeve të votimit nga KQV-të cakton:

- Një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim, të cilët përbëhen nga 2 anëtarë të KZAZ-së;
- Dy persona në ndihmë për çdo grup të marrjes në dorëzim, nga lista e anëtareve të GNV-ve, të cilët merren kryesisht me sistemimin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së.

Dy anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim dhe dy personat në ndihmë të tyre, propozohen nga Kryetari dhe Zv.kryetari i KZAZ-së, duke respektuar baraspeshimin shumicë-opozitë.

Sistemimi i materialeve të votimit në VNV

KZAZ-ja:

- ✓ Përcakton vendin ku do të vendosen:
 - Kutitë e votimit dhe kutitë me materiale të votimit, sapo ato merren në dorëzim nga Grupet e marrjes në dorëzim;
 - Kutitë e votimit dhe kutitë me materiale të votimit pas numërimit;

- Kutitë e vlerësuara "KUTI E PARREGULLT".
- ✓ Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit:
 - I rendit sipas numrit të QV-së.
 - E para në radhë, vendoset QV-ja me numër rendor më të vogël dhe vijon vendosja në rend rritës deri tek QV-ja e fundit më numër rendor më të madh.
 - QV-të bija vendosen menjëherë pas QV-së së origjinës.
 - Kutitë e një QV-je vendosen në pozicion vertikal, njëra mbi tjetrën:
 - poshtë kutia e materialeve të votimit dhe
 - sipër kutia e votimit me fletët e votimit.
- ✓ Merr në dorëzim, sapo mbërrijnë në VNV:
Kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit të çdo QV-je;

! Grupet e marrjes në dorëzim, në asnjë rast nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të kutisë së votimit me fletët e votimit, të kutisë me materialet e votimit të çdo QV-je.

- ✓ Grupi i marrjes në dorëzim:
 - Merr nga sekretari i KZAZ-së, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila përmban edhe procesverbalin e dorëzimit të vulave me kode sigurie MODEL KZAZ 23 "Për pajisjen e KQV nga KZAZ-ja me vula me kode të sigurisë".
 - Verifikon në çast përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë së vulave me të cilat janë mbyllur kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, me numrat e kodeve të sigurisë të shënuara në procesverbalin MODEL KZAZ 23 "Për pajisjen e KQV-së nga KZAZ-ja me vula me kode të sigurisë".
 - Shënon në procesverbalin MODEL KZAZ 24 "Për dorëzimin nga KQV në KZAZ të materialeve të votimit" numrat e kodeve të sigurisë të vulave, me të cilat është mbyllur kutia e votimit dhe kutia me materialet e votimit.

"Kutia e parregullt"

- ✓ Grupi i marrjes në dorëzim, gjatë marrjes në dorëzim të kutisë së votimit me fletët e votimit dhe kutisë me materialet e votimit, kur konstaton **parregullsi**:
 - a. **Mospërputhje të numrave të kodeve të sigurisë së vulave** me të cilat janë mbyllur kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, **me numrat e kodeve të sigurisë** të shënuara në procesverbalin **MODEL KZAZ 23** "Për pajisjen e KQV nga KZAZ me vula me kode të sigurisë";
 - b. **Një ose më shumë vula** me kode sigurie **mungojnë** ose **janë këputur**;
 - c. **Vendosja e vulave** me kodet e sigurisë është bërë në mënyrë të tillë që **lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj**;
 - d. **Kutia në trupin** apo në **kapakun e saj** ka **thyerje** ose **çarje** që **lejojnë futjen** apo **nxjerrjen e fletëve të votimit** apo **materialit tjetër të votimit**;
 - e. **Kutia** është e **llojit, formës** ose **përmasave të ndryshme** nga **ato të përcaktuara nga KQZ**.
- ✓ Informon menjëherë KZAZ-në për parregullsinë dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet "KUTI E PARREGULLT".

! Në këto raste, KZAZ-ja verifikon menjëherë rastin, dhe kur konstaton të paktën një parregullsi, e vlerëson kutinë si "KUTI E PARREGULLT".

- ✓ Parregullsia e konstatuar shënohet në Procesverbalin MODEL KZAZ 24 "Për dorëzimin nga KQV në KZAZ të materialeve të votimit" dhe në LPM dhe në Procesverbalin e Konstatimit.

Kujtesë!

Kutia e votimit e vlerësuar "KUTI E PARREGULLT":

- Në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapet nga KZAZ-ja dhe as nuk i kalon Grupit të Numërimit të Votave për vlerësim.**
- Vendoset në këndin e kutive të parregullta së bashku me **kutinë me materialet e votimit të QV-së përkatëse.**
- Dërgohet **së bashku me kutinë e materialeve të votimit** në KQZ për nevoja të hetimit administrativ.

Kutia me fletët e votimit, e marrë në dorëzim e rregullt, dhe kutia e materialeve të votimit e vlerësuar nga KZAZ-ja "KUTI E PARREGULLT", i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe vlerësimit, së bashku me kutinë e votimit me fletët e votimit.

KREU XI - SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE VEPRAT PENALE

XI.1 - Sanksionet administrative

Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve, kur nuk përbën vepër penale, **dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë** (neni 171/1).

Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen **me gjobë nga 1 000 deri në 2 500 lekë** (n. 171/2).

Shkelja e rregullave të përcaktuara në nenet 34 dhe 41 të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nga sekretari i KZAZ-së ose KQV-së, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë ose me **burgim deri në 6 muaj** (KZ, n.171/3).

Gjoba vendoset nga Komisioneri, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e financës në KQZ (V nr.5/2020, neni 29/3).

Shkelja e rregullave të tjera dhe afateve të parashikuara në pjesën II të Kodit Zgjedhor, kur nuk përbën shpërdorim të detyrës, sipas nenit 248 të Kodit Penal, **dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 100 000 lekë** (KZ, n. 171/5).

VEPRAT PENALE

❖ Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve (KP, n. 326)

Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe materialit zgjedhor, **me qëllim** ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve

a

- nëpërmjet paraqitjes në to të të dhënave, që dihen se janë të pasakta,
 - zëvendësimi i të saktave me të rreme ose
 - nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme
- dënohet me burgim 1-5 vjet.**

Kjo vepër kur kryhet nga **personat që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor**, ose

- ka sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e votimit,
 - ka cenuar integritetin e rezultatit të zgjedhjeve apo
 - ka sjellë pavlefshmërinë e tyre,
- dënohet me burgim nga 3 - 7 vjet.**

❖ Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor (KP, n. 326/a)

b

- Dëmtimi,
 - Prishja,
 - Shkatërrimi me dashje, apo
 - Zëvendësimi në kundërshtim me ligjin i **pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo materiali tjetër zgjedhor** të parashikuar nga ligji,
- dënohet me burgim nga 6 muaj – 5 vjet.**

Kur kjo vepër kryhet nga **personat përgjegjës për administrimin zgjedhor** ose, **në bashkëpunim**, ose **më shumë se një herë**, apo

- kur kanë sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e zgjedhjeve,
 - kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo
 - kanë cenuar rezultatit e votimit,
- dënohen me burgim nga 3 - 8 vjet.**

❖ Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje (KP, n. 329)

c

- Kanosja që i bëhet **zgjedhësit** për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën vepër penale dhe **dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.**

- Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet

- **Komisionerit,**
- **Vëzhguesit,**
- **Numëruesit** si dhe
- **Çdo zyrtari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet**

për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të veprimtarisë së tij në administrimin zgjedhor,

dënohet me burgim nga 1 - 4 vjet.

- Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë **dënohet me burgim nga 2-5 vjet.**

	<p>❖ Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve përbën vepër penale(KP, n. 330/a)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Braktisja e detyrës apo - refuzimi për të kryer detyrën <p>nga personat e ngarkuar me administrimin e procesit të votimit dhe të numërimit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga 6 muaj - 3 vjet.</p> <p>ç Kur këto veprime kryhen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • duke marrë me vete ose • duke zhdukur materialet zgjedhore, ose • kur kanë sjellë pasoja të rënda për procesin e votimit apo • kanë çuar në pavlefshmërinë e zgjedhjeve, <p>dënohet me burgim nga 2-7 vjet.</p> <p>Subjekte të kësaj vepre penale janë komisionerët, anëtarë të KZAZ, KQV (psh: marrja e vulës së Kryetarit të KQV-së).</p>
d	<p>❖ Pengimi i zgjedhësit (KP, neni 330)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pengimi i zgjedhësit për të votuar në qendrën e tij të votimit, <ul style="list-style-type: none"> • duke shkelur rregullat e votimit, • duke i marrë apo dëmtuar dokumentin e tij të identifikimit, apo në çdo formë tjetër dënohet me burgim nga 1-5 vjet. <p>- Kur kjo vepër kryhet më shumë se një herë, ndaj më shumë se një zgjedhësi apo kur kryhet nga komisionerët zgjedhorë, dënohet me burgim nga 3 - 7 vjet.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxitja me ose pa shpërblim, ose detyrimi i zgjedhësit për të shkelur rregullat që garantojnë fshehtësinë e votimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga 1 - 4 vjet.
e	<p>❖ Marrja ose përdormi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit (KP, n.331/a)</p> <p>Dhënia e dokumentit të identifikimit me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të paligjshme për zgjedhje, garantimin e mospjesëmarrjes në votime, për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga 1-3 vjet.</p> <p>Marrja e dokumentit të identifikimit të shtetasve të tjerë, me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të paligjshme për zgjedhje, moslejimin për të votuar, për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga 1 - 5 vjet.</p>

f	<p>❖ Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar (KP, n. 327/a)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje, • votimi për persona të tjerë, duke paraqitur <i>dokumente identifikimi të rreme</i> apo <i>duke përdorur dokumente të zgjedhësve të tjerë</i> dënohet me burgim nga 1 - 3 vjet. <p>- Lejimi me dashje i kryerjes së kësaj vepre nga komisionerët zgjedhorë dënohet me burgim nga 1 - 5 vjet.</p> <p>- Lejimi me dashje nga komisionerët zgjedhorë i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga 6 muaj - 3 vjet.</p>
g	<p>❖ Shkelja e fshehtësisë së votimit (KP, neni 327)</p> <p>Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e zgjedhësit, nëpërmjet fotografimit të fletës së votimit, ose filmimit të saj, ose dokumentimit me çdo mjet dhe formë të mënyrës sesi ka votuar, shfaqjes së tyre tek personat e tjerë, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga 6 muaj deri në tre vjet.</p> <p>Nxitja me ose pa shpërbllim, ose detyrimi i zgjedhësit për të shkelur rregullat që garantojnë fshehtësinë e votimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga 1-4 vjet.</p>
I	<p>❖ Shkelja e së drejtës së zgjedhjes (KP, neni 331)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mospërfshirja me dashje në listat e zgjedhësve e personave që e kanë të drejtën e zgjedhjes ose • regjistrimi me dashje në to i personave që nuk e kanë këtë të drejtë, dënohet me burgim nga 1 -5 vjet. <p>Kjo vepër e kryer në bashkëpunim, kur ka sjellë pasoja të rënda për</p> <ul style="list-style-type: none"> • interesat e zgjedhësve apo • mbarëvajtjen e procesit zgjedhor <p>dënohet me burgim nga 2 - 5 vjet.</p>

KREU XII - TESTI NJOHURIVE

Qarkoni alternativën e saktë!

1. Cilat janë organet drejtuese të KQZ-së?

- a) Komisioni Rregullator;
- b) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
- c) Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve
- d) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator, Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve.

2. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së emërohen në detyrë me vendim të:

- a) Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- b) Komisionit Rregullator;
- c) Partisë politike që i ka propozuar.

3. KQZ-ja dërgon në KZAZ materialet zgjedhore për KQV-të dhe GNV-të:

- a) Jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve;
- b) Jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve;
- c) 24 orë para fillimit të procesit të votimit.

4. KZAZ-ja shpërndan materialet zgjedhore për çdo QV në juridiksionin e saj:

- a) 24 orë para hapjes së procesit të votimit;
- b) 3 ditë para datës së zgjedhjeve;
- c) Jo më vonë se ora 15:00 e datës 24.04.2021.

5. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së shkarkohen dhe lirohen nga detyra me vendim të:

- a) Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- b) Partisë politike që i ka propozuar;
- c) Komisionit Rregullator.

6. KZAZ-ja ngre një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore/të votimit të sjella nga KQV-të, të përbërë nga:

- a) Dy anëtarë të KZAZ-së, të propozuar përkatësisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së;
- b) Dy anëtarë të KZAZ-së.

7. Kutia e votimit me fletët e votimit, e marrë në dorëzim nga KZAZ-ja dhe e përcaktuar "KUTI E PARREGULLT":

- a) Në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapet nga KZAZ-ja dhe as nuk i kalon Grupit të Numërimit të Votave për vlerësim.
Vendoset në këndin e kutive të parregullta së bashku me kutinë me materialet e votimit të QV-së përkatëse.
Dërgohet së bashku me kutinë e materialeve të votimit në KQZ për nevoja të hetimit administrativ.
- b) Nuk hapet nga KZAZ-ja dhe dërgohet së bashku me kutinë e materialeve të votimit në KQZ për nevoja të hetimit administrativ.

8. Grupi i marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore/të votimit:

- a) Funkcionon për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore/të votimit të sjella nga KQV-të në KZAZ/VNV;
- b) Gjatë marrjes në dorëzim të kutisë së votimit me fletët e votimit dhe kutisë me materialet e votimit, kur konstaton parregullsi:
- Informon menjëherë KZAZ-në për parregullsinë që konstaton dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet "KUTI E PARREGULLT";
- c) Në asnjë rast nuk mund të refuzojë marrjen në dorëzim të kutisë së votimit me fletët e votimit dhe kutisë me materialet e votimit të çdo QV-je, në juridiksion të KZAZ-së përkatëse;
- d) a, b, c.

9. Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të kutive me fletët e votimit dhe kutisë së materialeve të votimit, grupi i marrjes në dorëzim, njofton menjëherë KZAZ-në për parregullsinë dhe i kërkon asaj, që kutia përkatëse të shënohet "KUTI E PARREGULLT". Anëtarët e KZAZ-së përkohësisht ndërpresin punën e tyre, dhe :

- a) - Verifikojnë parregullsinë e konstatuar,
- I vendosin etiketën "KUTI E PARREGULLT";
- b) - Paraqiten tek vendi i dorëzimit të kutive përkatëse të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit;
- Verifikojnë parregullsinë e konstatuar;
- Marrin vendim, duke e vlerësuar kutinë/kutitë si të parregullt;
- I vendosin etiketën "KUTI E PARREGULLT";
- dhe e vendosin në këndin e kutive të parregullta.

10. Pjesëmarrja e anëtarëve të KZAZ-ve në programet e trajnimit është:

- a) Fakultative;
- b) Detyrim ligjor;
- c) Vullnet i partisë politike, që e ka propozuar anëtarin apo sekretarin e KZAZ-së.

11. Anëtari i KZAZ-së, që jep dorëheqjen, e depoziton/paraqet atë:

- a) Te partia politike që e ka propozuar;
- b) Në KZAZ.

12. Në qoftë se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës :

- a) Kryetari apo dy anëtarë të KZAZ-së, i dërgojnë Komisionerit për shqyrtim çështjen, brenda 24 orëve. Vendimi i Komisionerit është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KZAZ-ja.
- b) Rasti vihet në rendin e ditës në mbledhjen e ardhshme të KZAZ-së.

13. Vendimet e marra nga KZAZ-ja:

- a) Merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së;
- b) Nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim;
- c) Secili prej anëtarëve të KZAZ-zë, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën "pro" ose "kundër" si dhe arsyetimin përkatës;
- d) Shoqërohen me mendimin e pakicës, nëse ka të tillë.
- e) Të gjitha.

14. Vota e anëtarit të KZAZ-së që është në kushtet e konfliktit të interesit, por nuk është liruar nga detyra, është:

- a) E pavlefshme dhe nuk llogaritet në kuorum;
- b) E pavlefshme;
- c) Nuk llogaritet në kuorum.

15. Vendimi i marrë nga KQZ-ja regjistrohet në:

- a) Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së;
- b) Regjistrin e Korrespondencës të KZAZ-së;
- c) Regjistrin e Vendimeve të KZAZ-së;
- d) Regjistrin e Vendimeve të KZAZ-së, Librin e Protokollit të Mbledhjeve; Regjistrin e Korrespondencës të KZAZ-së (kopje të vendimeve dërgohen menjehere, sipas rastit, në KQZ, subjekteve zgjedhore, vëzhguesve ose personave të tretë.

16. Vëzhguesit akreditohen nga:

- a) KZAZ-ja
- b) KQZ-ja
- c) a, b.

17. Një kandidat i një partie politike:

- a) Mund të jetë i pranishëm gjatë mbledhjeve të KZAZ-së;
- b) Mund të jetë i pranishëm gjatë mbledhjeve të KZAZ-së nëse vetëm ai ose ajo është i akredituar si vëzhgues.

18. Anëtarët e komisionit të qendrës së votimit (KQV) emërohen nga:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,
- b) Partia politike, që i ka propozuar;
- c) Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor.

19. Gjatë vendimmarrjes, anëtarët e KZAZ-së komunikojnë më palët e treta :

- a) Nëpërmjet telefonit celular;
- b) Direkt me personin e tretë;
- c) Nuk komunikojnë fare.

20. Qendrat e votimit mund të caktohen në:

- a) ambiente me sipërfaqe më të vogël se 30 m²;
- b) institucione të posaçme pavarësisht numrit të zgjedhësve në to;
- c) objekte arsimore dhe social-kulturore;
- d) ndërtesa private nga Kryetari i Bashkisë;
- e) ndërtesa që përdoren nga administrata publike;

21. KZAZ-ja njofton, me shkrim, brenda datës 10 prill 2021, partitë politike të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve, dhe u kërkon atyre të paraqesin propozimet, së bashku me dokumentacionin përkatës, për emërimin e tyre:

- a) Brenda datës 13 prill 2021;
- b) Brenda datës 15 prill 2021.

22. Zgjedhësi, kur vëren se:

- ✓ Përbërësit e tij zgjedhorë kanë pasaktësi;
- ✓ Nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij;
- ✓ Nuk është i regjistruar fare në ndonjë nga listat e zgjedhësve të ZAZ-së ku ka vendbanimin.

Ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve.

- a) Deri më datë 23 prill 2021, por i pajisur nga Sekretari i KZAZ-së me vërtetim, sipas rastit,
Model **KZAZ-15**, kur emri i zgjedhësit nuk gjendet në listat e zgjedhësve të ZAZ-së.
Model **KZAZ-16**, kur emri i zgjedhësit është i regjistruar në listën e zgjedhësve të kësaj ZAZ-je, por jo në zonën e qendrës së votimit të vendbanimit të tij.
- b) Deri 48 orë përpara datës së zgjedhjeve.

23. Kutia me fletët e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, vlerësohen nga KZAZ "KUTI E PARREGULLT" kur ka:

- a) Mospërputhje të numrave të kodeve të sigurisë së vulave me të cilat janë mbyllur kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, me numrat e kodeve të sigurisë të shënuara në procesverbalin MODEL KZAZ 23 "Për pajisjen e KQV nga KZAZ me vula me kode të sigurisë";
- b) Një ose më shumë vula me kode sigurie mungojnë ose janë këputur;
- c) Vendosja e vulave me kodet e sigurisë është bërë në mënyrë të tillë që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;
- d) Kutia në trupin apo në kapakun e saj ka thyerje ose çarje që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialit tjetër të votimit;
- e) Kutia është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara nga KQZ.
- f) a, b, c, d, e (të gjitha).

24. Kutia e votimit me fletët e votimit, e përcaktuar si "KUTI E PARREGULLT":

- a) Numërohet nga GN pas vendimit të KZAZ-së;
- b) Në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapet dhe nuk numërohet.

25. Kutia me fletët e votimit, e marrë në dorëzim e rregullt, dhe kutia e materialeve të votimit e vlerësuar nga KZAZ-ja "KUTI E PARREGULLT":

- a) I nënshtrohet procedurave të hapjes dhe vlerësimit së bashku me kutinë e votimit me fletët e votimit;
- b) Në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapet.

26. Dokumentacioni i punës së KZAZ-së në procesin e dorëzimit të materialeve të votimit nga KQV-ja në KZAZ është:

a)

- o Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së,
- o Regjistri i Vendimeve të KZAZ-së,
- o Regjistri i Korrespondencës të KZAZ-së,
- o Vërtetim për zgjedhësit që janë në listën e zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor,
- o Vërtetim për zgjedhësit që nuk janë në listën e zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor,
- o Vërtetim i posaçëm për anëtarin e KZAZ-së.

b)

- o Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së,
- o Regjistri i Vendimeve të KZAZ-së,
- o Regjistri i Korrespondencës të KZAZ-së,
- o Procesverbal Konstatimi.

27. Komunikimi KZAZ-KQV deri një ditë para datës së zgjedhjeve, kryesisht ka të bëjë me:

- a) Njoffimin për trajnimin e anëtarëve të KQV-ve, zbatimin e detyrimit ligjor, në rastet e mospjesëmarrjes në trajnim;
- b) Njoffimin për paraqitjen në orën e caktuar në KZAZ, për tërheqjen e bazës materiale zgjedhore;
- c) Marrjen e informacionit për:
 - Praninë e punonjësit të Policisë së Shtetit, kur mbërrin baza materiale zgjedhore në QV (24 Prill 2021);
- d) Të gjitha.

28. Komunikimi KZAZ-KQV ditën e zgjedhjeve, kryesisht ka të bëjë me marrjen e informacionit:

- a) Një orë para hapjes së votimit, paraqitjen e anëtarëve të KQV në QV përkatëse;
- b) Në momentin e hapjes së QV-së, rezultatet e inventarizimit të bazës materiale zgjedhore;
- c) Rastet kur në QV, ose në rrethinat e saj është cënuar rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit, orën e pezullimit dhe orën e rifillimit të votimit;
- d) Orën e mbylljes së votimit dhe shoqërimin e materialeve të votimit në KZAZ.
- e) Të gjitha.

29. Sekretari KZAZ-së regjistron/shënon të gjitha pasaktësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procesit të marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe materialeve të votimit nga KQV-ja në KZAZ dhe procesit të numërimit të votave në VNV:

- a) Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së dhe Procesverbalin e Konstatimit;
- b) Procesverbalin e Konstatimit.

30. Grafiku i KZAZ-së për shpërndarjen e materialeve zgjedhore të KQV-të dhe dorëzimin e materialeve të votimit nga KQV-të në KZAZ dërgohet, i firmosur nga:

- a) *Kryetari dhe zv.kryetari i KZAZ-së, i vulosur nga sekretari me vulën e KZAZ-së, jo më vonë se data 18 Prill 2021, në Komisaratin e Policisë të njësisë së vetëqeverisjes vendore;*
- b) *Kryetari, jo më vonë se data 18 Prill 2021, në Komisaratin e Policisë të njësisë së vetëqeverisjes vendore;*
- c) *Kryetari, i vulosur nga sekretari me vulën e KZAZ-së, jo më vonë se data 18 Prill 2021, në Komisaratin e Policisë.*

Përgjigjet e Testit të njohurive

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja	d	a	a	c	a	a	a	d	b	b
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Përgjigja	b	a	e	a	d	c	a	c	c	c
Pyetja	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
Përgjigja	a	a	f	b	a	b	d	e	a	a

Rëndësia e pjesëmarrjes së anëtarëve të KZAZ-ve në programet e trajnimit

- Pjesëmarrja e anëtarëve të KZAZ-së në trajnim është detyrim ligjor!
- Anëtarët e KZAZ-ve, pjesëmarrës në programin e trajnimit do t'i nënshtrohen testimit.
- Anëtari i ri i KZAZ-së, i emëruar pas plotësimit të vendit vakant të krijuar, për çdo shkak, do t'i nënshtrohet trajnimit dhe testimit.
- Mospjesëmarrja në trajnim, moskalimi i testit, përbën shkak ligjor për shkarkim nga detyra.

**Shtetasit të cilët janë listuar në listën e miratuar nga Komisioneri, edhe nëse nuk janë emëruar kryesisht nga Komisioneri apo KZAZ si anëtarë të KZAZ apo të KQV-së mund të marrin pjesë në trajnimet që organizon KQZ-ja dhe do t'i nënshtrohen testimit për njohuritë e fituara.*

Programet dhe kurset e trajnimit do të ofrojnë:

- Informimin dhe përvetësimin e njohurive të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të KQZ-së;
- Aftësimin e komisionerëve në aspektin praktik duke zbatuar korrektësisht procedurat ligjore;
- Aftësimin e komisionerëve për zbatimin e rregullave të etikës, në çdo situatë problematike të krijuar, në përputhje me kuadrin ligjor;
- Forcimin e frymës së bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të KZAZ-së, me synim krijimin e një ambienti mbështetës, të besueshëm, të paanshëm, të përgjegjshëm, për t'i dhënë sa më shumë vlera mirëadministrimit të procesit zgjedhor.

Gjithashtu, kurset e trajnimit do të ndikojnë në kualifikimin profesional të komisionerëve, qartësimin e procedurave ligjore, aftësitë për të vënë në praktikë njohuritë e marra, forcimit të besimit, kompetencave, besueshmërisë dhe kurajos, bashkëpunimit për gjetjen e zgjidhjeve të bazuara në prova e fakte, konsensusit, tolerancës, besimit, stimulimit të ideve, shuarjes së mosmarrëveshjeve, komunikimit, menaxhimit efektiv të procesit.

ZGJIDH, VOTO, VENDOS!

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN
25 PRILL 2021

Masa mbrojtëse anti Covid - 19



DEZIFEKTONI DUART



MBANI MASKË



RUANI DISTANCËN 1.5 M

Anëtarët e KZAZ-së, në funksion të mbrojtjes së shëndetit për parandalimin dhe kufizimin e transmetimit të infeksionit COVID-19, gjatë ushtrimit të detyrës duhet të zbatojnë rregullat për masat e higjienës dhe të distancimit fizik, në përputhje me rekomandimet dhe protokollet e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP).

Në Selinë e KZAZ-së, çdo anëtar duhet të përdorë mjetet mbrojtëse për shëndetin, maskë higjienike, të zbatojë rregullat e higjienës për larjen e shpeshtë të duarve dhe të respektojë distancimin fizik.



www.kqz.gov.al



info@kqz.gov.al



[@kqz.gov.al](https://www.instagram.com/kqz.gov.al)



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

